



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



Fondi i Grave të Kosovës

Grante të Vogla, **Ndryshime të mëdha**

2015-2016



© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, dhjetor 2016

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, duke cituar autorët.

Ky publikim është publikuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është vetëm përgjegjësi e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian.

www.womensnetwork.org

Printuar në letër të riciklueshme nga Night Design në Prishtinë.

Përmbajtja

Hyrje	6
Një histori e shkurtër për Fondin e Grave të Kosovës	6
Si funksionon Fondi i Grave të Kosovës?	9
Më shumë se vetëm një grant.....	10
Mos Hesht! Raporto ngacmimet seksuale	11
Ligji për Personat e Verbër po zbatohet çdo ditë e më shumë	14
Partners-Kosova avokon për të drejtat e grave në pronë dhe trashëgimi	15
PEA kontribuon në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore	17
Gratë dhe vajzat e Dragashit dalin me hulumtim për qasjen në kujdesin cilësor shëndetësor	19
Gratë shqiptare dhe serbe bashkëpunojnë dhe fuqizojnë njëra tjetrën	21
Bashkëpuim më i mirë në mes të grave asambleiste në Kosovën veriore.....	23
Personat me aftësi të kufizuara fuqizohen për t'u bërë aktivë brenda komuniteteve të tyre.....	26

Gjilani dhe Vitia fillojnë institucionalizimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor	29
Skenderaj i bashkohet nismës “Së bashku kundër dhunës në familje”	32
Qytetarët e Pejës bashkohen për t’i dhënë fund dhunës në baza gjinore	34
Gratë në zonat rurale mësojnë për shëndetin riprodhues.....	37
<i>Naš Dom</i> mbështet iniciativën e buxhetimit gjinor	38
Gratë vetëdijesohen për sëmundjen e osteoporozës	40
Rikotta dhe Shoqata e Grave Gora bashkëpunojnë për të drejtat e grave në pronësi.....	42
“Venera” avokon mbi të drejtën e gruas në pronë	43
Mbroj të Drejtat e Tua ngrit vetëdijesimin kundër dhunës në familje në komunën e Deçanit.....	45
Vajzat në Prizren bashkëpunojnë me asambleistet.....	48
Gratë e Shtërpçës më të përgaditura për hapjen e bizneseve 49	
Gratë e fshatrave të Prishtinës kyçen sukseshëm në tregun mobil.....	51
Komuna e Mamushës me Plan të Veprimit për Barazi Gjinore	52
Gratë, vajzat dhe burrat vetëdijesohen për të drejtat mbi pronë dhe trashëgimi	54

Speranza në solidaritet me gratë që përjetojnë dhunë në familje.....	55
Shoqata e Femrave të Shurdhëra avokon për të drejtat e grave në shëndetësi.....	57
Të diplomuarit Rom, Ashkali dhe Egjiptian aftësohen për punë	58

Hyrje

Nga fillimi i vitit 2015 deri në përfundim të vitit 2016 përmes përkrahjes së Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) ka ndarë 26 grante për organizatat anëtare të saj përmes Fondit të Grave të Kosovës (FGK), që arrijnë shumën në vlerë prej 100,818.10€.

Nga këto iniciativa kanë **përfiturar 2632 persona të ndryshëm** duke përfshirë persona me aftësi të kufizuara fizike, nga zonat rurale, të etnive të ndryshme (p.sh., turke, gorane, serbe, rome, ashkallike, egjiptiane, boshnjake dhe shqiptare), burra, të rinj dhe pensionistë. Nga ky numër, **713 gra kanë marrë pjesë në procese vendimmarrëse** gjatë **96 iniciativave avokuese** të ndërmarura.

Gjatë këtyre dy viteve, organizatat anëtare të RrGGK-së kanë pasur mundësinë të aplikojnë për dy lloje të granteve: Grante individuale për avokim (deri në 3,000€) dhe Grante avokimi në partneritet për ndryshim (deri në 8,000€) ku dy organizata mund të aplikojnë për një iniciativë të përbashkët.

Këtë vit, janë shpërndarë 26 grante, prej të cilave 6 grante në partneritet për ndryshim dhe 20 grante avokimi individual për një organizatë. Këto grante kanë arritur ndryshime të mëdha në një periudhë të shkurtër kohore. Kjo broshurë tregon historitë e tyre.

Një histori e shkurtër për Fondin e Grave të Kosovës

Me mbështetje nga Kvinna till Kvinna (KtK), e më pas edhe

nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Fondacioni IPKO, RrGGK themeloi fondin për të siguruar grante të vogla për organizatat e grave që nuk kanë qasje në burime të tjera të financimit.

Në vitin 2015, Fondi i Grave të Kosovës u mbështet nga Austrian Development Agency (ADA) dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Fondi i Grave të Kosovës u krijua pas një sërë konsultimesh me organizatat anëtare të RrGGK-së lidhur me nevojat dhe vizionin e tyre për Fondin.

FGK plotëson nevojën qenësore për të mbështetur organizatat e grave financiarisht, si rrjedhojë e ndryshimit të prioriteteve të donatorëve në Kosovë.

Zvogëlimi i buxheteve ka detyruar shumë donatorë në Kosovë që të mbyllin programet e tyre të granteve ose të zvogëlojnë fondet për organizatat joqeveritare.

Donatorë të tjerë kanë fonde që për organizatat lokale janë jashtëzakonisht të vështira për t'iu qasur. Grupet e grave që kanë njohuri të kufizuara të gjuhës angleze kanë vështirësi të marrin fonde të tilla.

Megjithatë, organizatat e udhëhequra nga gratë janë të pozicionuara mirë për të ndërmarrë iniciativa shumë efikase dhe efektive drejt barazisë gjinore dhe të drejtave të grave në nivel komunal, ashtu siç ka dëshmuar edhe Fondi i Grave të Kosovës i RrGGK.

Përmes Fondit të Grave të Kosovës, ne përpiqemi që të sigurohemi që iniciativat e tyre të rëndësishme të vazhdojnë të kenë mbështetje.

Të arriturat kryesore të Fondit të Grave të Kosovës

- 2632 gra të ndryshme (dhe burra) kanë përfituar nga fillimi i vitit 2015 deri në përfundim të vitit 2016
- 713 gra kanë marrë pjesë në procese vendimmarrëse (disa prej tyre për herë të parë)
- Janë ndërmarr gjithsej 96 iniciativa avokuese
- 8 politika publike kanë ndryshuar për të përkrahur më mirë nevojat e grave dhe vajzave, si rezultat i iniciativave avokuese të përfitueseve të granteve
- Ka rritur kapacitetin e anëtareve të RrGGK-së për të planifikuar më mirë dhe për të shkruar projekt propozime. Si rezultat, anëtarët e RrGGK-së, përfshirë edhe grupet rurale dhe të minoriteteve, kanë aplikuar dhe fituar për herë të parë mbështetje financiare nga donatorë të ndryshëm
- Kryetarë të komunave të ndryshme dhe zyrtarë për barazi gjinore janë përfshirë në iniciativat e anëtareve të RrGGK-së
- Anëtarët e RrGGK-së janë aftësuar për avokim përmes “qasjes së të mësuarit duke vepruar” dhe disa prej tyre kanë ndërmarrë iniciativa avokuese për herë të parë
- Anëtarët e RrGGK-së ofruan bashkë-financim të konsiderueshëm për iniciativat e tyre
- Anëtarët e RrGGK-së kanë fituar njohuri në krijimin dhe mirëmbajtjen e databazave për monitorim dhe vlerësim të punës së tyre

Si funksionon Fondi i Grave të Kosovës?

Organizatet e ndryshme anëtare të RrGGK-së inkurajohen që të dorëzojnë aplikacione për iniciativa që do të kontribuojnë në realizimin e qëllimeve strategjike të identifikuara në Planin Strategjik të RrGGK-së për vitet 2015-2018. Anëtarët e RrGGK-së vetë i kanë përzgjedhur këto qëllime përmes një procesi konsultativ. Ato përfshijnë:

- Fuqizimin e RrGGK-së dhe anëtareve të saj;
- Mbështetjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimin e qasjes së grave në kujdes shëndetësor cilësor;
- Luftën kundër dhunës në familje dhe trafikimit të personave;
- Fuqizimin ekonomik të grave.

Organizatet e grave mund të aplikojnë për fonde në gjuhën shqipe, serbe apo angleze duke përdorur Formën e Aplikimit që gjendet në uebfaqen e RrGGK-së www.womensnetwork.org.

Për të aplikuar për grante të Fondit të Grave të Kosovës, një organizatë duhet të jetë anëtare e RrGGK-së; të ndërmarr iniciativë avokuese për përkrahjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të grave dhe vajzave; të planifikojë dhe zbatojë aktivitete në përputhje me strategjinë e tyre organizative; të ndërmarrë aktivitete që kontribuojnë në Planin Strategjik të RrGGK-së; të arrijë tek komuniteti dhe/ose personat dhe grupet e marginalizuara; dhe t'iu mungojnë mundësitë tjera të sigurimit të fondeve.

Komisioni Përzgjedhës për Grante i Fondit të Grave të Kosovës, i përzgjedhur në baza vjetore nga anëtarët e RrGGK-së, takohet dy herë në vit për të vendosur nëse projekt propozimet

i përmbushin kriteret e lartëcekura dhe për të miratuar grantet duke përdorur një sistem të bazuar në mbledhjen e pikëve.

Më shumë se vetëm një grant...

RrGGK gjithashtu ofron mundësi për zhvillimin e kapaciteteve për aplikueset për grante dhe përfitueset e granteve, për të forcuar organizatat tona anëtare dhe rjetin tonë.

RrGGK ofron punëtori, si dhe mentorim individual në shkrimin e granteve, menaxhim të ciklit të projekteve dhe menaxhim financiar, duke përkrahur më tutje kapacitetet e organizatave për të aplikuar për fonde nga donatorët e tjerë në të ardhmen.

Mbështetja e RrGGK-së për përfituesit e granteve nuk përfundon edhe pasi të jetë ndarë granti. Ne vazhdojmë të ofrojmë mentorim individual për secilin përfitues të granteve përgjatë iniciativës së tyre dhe shpesh edhe më pas.

Kjo përfshin vizita në teren, ndërtimin e shkathtësive në menaxhim financiar, ndihmë lidhur me menaxhimin organizativ, këshillime lidhur me strategjitë efektive avokuese, lehtësimi i bashkëpunimit me zyrtarë qeveritarë dhe zgjidhjen e problemeve.

Ne po ashtu mbështesim anëtarët tona në të menduarit proaktiv lidhur me qëndrueshmërinë, që përfshinë planifikimin e iniciativave dhe përfitimin e mbështetjes në nivel të komunitetit për t'iu mundësuar që iniciativat e tyre të vazhdojnë edhe pas këtyre projekteve të shkurtra.

“Ky fond shërben për shumë gjëra, duke filluar nga mënyra e aplikimit për një projekt të denjë e deri te raportimi.”

- Anëtare e RrGGK

Për më shumë informata lidhur me Fondin e Grave të Kosovës, ju lutem vizitoni uebfaqen tonë (www.womensnetwork.org). Ekipi i RrGGK-së mund t'iu ofrojë informata shtesë përmes e-mailit në grants@womensnetwork.org ose përmes telefonit në +381 (0)38 245 850. Ju lutem na kontaktoni ju apo dikush nga organizata juaj, nëse jeni të interesuar të përkrahni Fondin e Grave të Kosovës.

Mos Hesht! Raporto ngacmimet seksuale

Dihet se 48.5% e kosovarëve kanë përjetuar ndonjë formë të ngacmimit seksual gjatë jetës së tyre, ndërkohë që vetëm në vitin 2014, 45.2% kanë përjetuar këtë lloj ngacmimi. Universitetet publike kanë një Kod të Mirësjelljes, ku termi “ngacmim seksual” nuk përmendet në mënyrë të qartë ose të përcaktuar dhe mekanizmat raportues janë të paqartë. Si pasojë, raportimi i ngacmimeve seksuale në universitete është minimal.

Prandaj, më shumë se 200 studentë janë njoftuar rreth ngacmimeve seksuale dhe pasojave negative në shëndetin e viktimave, përmes projektit “Adresimi i ngacmimit seksual dhe krijimi i mekanizmave mbrojtës në Universitetet Publike në Prishtinë dhe Gjakovë”, implementuar në vitin 2015 nga Artpolis së bashku me Femrat Aktive të Gjakovës (FAGJ) me mbështetje të Fondit të Grave të Kosovës (me vlerë prej 7,600€).



Artpolis dhe FAGJ kanë informuar studentet në Universitetin e Prishtinës dhe atij të Gjakovës se si mund të adresohen ngacmimet seksuale dhe të ngriten mekanizma mbrojtës brenda këtyre universiteteve, përmes takimeve të ndryshme me ta. Në mënyrë të veçantë, 41 studente janë njoftuar nga afër me legjislacionin kosovar kundër ngacmimeve seksuale, si dhe identifikimin, adresimin dhe raportimin e ngacmimeve seksuale brenda universiteteve të tyre.

Ato u takuan me zyrtarë të universiteteve dhe institucioneve arsimore siç janë rektoratet, dekanatët dhe grupet studentore, dhe me vullnet lobuan për krijimin e mekanizmave për adresimin e ngacmimeve seksuale. Si rezultat i këtyre takimeve, Rektori i Universitetit të Gjakovës ka prezantuar projektin dhe kërkesën para senatit të Universitetit të Gjakovës. Ai u premtoi studenteve se do të inicioj krijimin e këtij mekanizmi, por se kjo do të marrë pak kohë, duke pasë parasysh rrethanat dhe sfidat brenda Universitetit.

“Duke ditur se shumë gra nuk e kanë të qartë se çfarë është ngacmimi seksual apo si ta raportojnë dhe burrat nuk janë të vetëdijshëm se ata seksualisht ngacmojnë gratë, është një rrugë e gjatë dhe e vështirë, por ne duhet të vazhdojmë të punojmë në vetëdijesimin mbi këtë çështje”, tha Zana Hoxha-Krasniqi, Drejtore Ekzekutive e Artpolis.

Gjatë kontaktit me studentët, është parë që vajzat dhe djemtë nuk janë mjaft të informuar për ngacmimin seksual, dhe shumë nga djemtë janë shprehur se nuk kanë qenë të vetëdijshëm që po ngacmojnë.

“Unë nuk e kam dijtë që po ngacmoj pasi kam menduar që jam duke flirtuar”, është shprehur njëri nga djemtë pjesëmarrës. “Ne nuk e kemi dijtë që nëse i themi një vajzës sa e bukur qenke ose nëse insistojmë vazhdimisht për të marrë një

numër të telefonit apo instagramin është ngacmim. Kemi menduar që vajzat ndjehen mirë nëse i ngacmojmë vazhdimisht”.

Si pjesë e projektit, pesë studente të këtyre universiteteve së bashku me aktorët profesional luajtën në performancën artistike, vetëdijesuese dhe avokuese “Mos Hesht”, e cila u shfaq gjatë muajit dhjetor në të dyja universitetet në Prishtinë dhe Gjakovë, duke iu qasur një numri të madh të studentëve dhe mësimdhënësve prezent. Të fuqizuara, pas secilës shfaqje studentet shpërndanë broshura informuese në të gjitha fakultetet një nga një, duke i vendosur në tabelat përkatëse. Ato poashtu informuan kolegët e tyre, studentët e interesuar të rastit dhe stafin e universitetit, për ngacmimin seksual dhe mënyrat se si mund të raportohet ngacmimi seksual kur nodh brenda universitetit.

Trajtimi i ngacmimeve seksuale në universitetet kosovare mbetet sfidë si pasojë e mungesës së vullnetit të institucioneve përkatëse për t’i adresuar ato. Por, tani një numër i konsiderueshëm vajzash dhe djemsh të fuqizuar dhe të vetëdijshuar nuk do të heshtin gjatë ballafaqimit me ngacmimet seksuale jo vetëm në universitet, por kudo. Artpolis vazhdojë këtë iniciativë, edhe me përkrahjen e donatorëve të tjerë, duke u zgjeruar në universitetet e tjera publike në Mitrovicë dhe Prizren. Për më tepër, Artpolis planifikon të përpiloj një dokument të politikave për të gjitha universitetet publike, në mënyrë që politikat e nevojshme për këtë çështje të bëhen pjesë e të gjitha politikave ekzistuese të këtyre Universiteteve.

Ligji për Personat e Verbër po zbatohet çdo ditë e më shumë

Duke parë problemet që personat e verbër hasin çdo ditë, Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës (KGVK) ka organizuar takime konsultative edhe me shoqata të tjera, ku kanë kanë identifikuar ngecjet dhe problemet e konkretizuara lidhur me mos zbatimin e Ligjit për Personat e Verbër, Nr. 04/L-092, specifikisht nenit 13, i cili rregullon transportin publik për personat e verbër.

Për të ndërmarrë masa për këto probleme, KGVK ka filluar avokimin për sigurimin e transportit pa pagesë për personat e verbër, në vitin 2015, me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,750€). Përfitues të këtij projekti ishin personat e verbër dhe me të pamurit të dobësuar.

Në mënyrë intensive, ato organizuan takime me zyrtarë komunal për të avokuar sa më shumë drejt përmirësimit të kësaj çështje. Zyrtarëve të komunës së Prishtinës u është sugjeruar që operatorët ekonomik të linjave urbane të obligohen të respektojnë këtë ligj. Gjatë një takimi, kryetari i komunës së Prishtinës Shpend Ahmeti është zotuar se do të bëhet gjithçka që është e mundur për sigurimin e transportit pa pagesë për personat e verbër. Deri tani,



linjat urbane nuk janë rregulluar bazuar në kërkesat e personave të verbër. Megjithatë, jo shumë kohë pas takimit, komuna e Prishtinës ka investuar në përmirësimin e një trotuari, nga Hotel Grand deri tek Ministria e Drejtësisë, që të jetë i përshtatshëm për personat e verbër. “E arritëm këtë qëllim që ka qenë shumë i nevojshëm për personat e verbër, të cilët dhe janë ndarë të kënaqur me avokimin dhe punën që është bërë”, është shprehur e gëzuar Bajramshahe Jetullahu, Drejtore Ekzekutive e KGVK.

Ato kanë mbajtur takime edhe me Gratë Deputete si dhe me asambleistet e Komunës së Prishtinës të cilat janë informuar lidhur me mangësitë në zbatimin e ligjit. Me mbështetjen e plotë të tyre, së bashku kanë vendosur që në muajin shtator, të organizohet një punëtori i përbashkët me qëllim të njoftimit të autoriteteve relevante për mos zbatimin e ligjit. Përmes takimeve, KGVK ka arritur që të bind institucionet relevante të zbatojnë në praktikë Ligjit për Personat e Verbër, më konkretisht nenin 13, si dhe është bërë nxjerrja e rekomandimeve të përbashkëta me qëllim të adresimit të sfidave konkrete.

Në të njetën kohë kur po implementohej ky projekt, KGVK ka arritur të filloj dhe një projekt tjetër për të vazhduar avokimin për disa nene tjera të po të njetit ligji. RrGGK në mënyrë të vazhdueshme ka ofruar mbështetje për KGVK, për të kontribuar në mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të verbër në Kosovë.

Partners-Kosova avokon për të drejtat e grave në pronë dhe trashëgimi

Siç e dimë, të drejtat e grave në pronë dhe trashëgimi, paraqesin një sfidë të madhe në shoqërinë kosovare meqenëse pasuria

familjare në shumicën e rasteve ndahet mes burrave dhe djemve të familjes. Për këtë arsye Partners-Kosova Center for Conflict Management ka vazhduar edhe këtë vit me iniciativën për ngritjen e vetëdijes dhe avokimin për pjesëmarrjen e grave në të drejta pronësore dhe trashëgimi me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,390€), pasi që një iniciativë e ngjashme është mbështetur nga Fondi edhe në vitin 2014.

Partners Kosova ka bashkëpunuar me grupe të vajzave dhe të djemve, grave dhe burrave, si dhe me përfaqësues të institucioneve të ndryshme në komunën e Malishevës dhe Rahovecit, për të ngritur vetëdijesimin dhe për të ofruar informata se si të avokohet për të drejtën e grave në pronë dhe trashëgimi.

Ky bashkëpunim ka përfshirë takime me zyrtarët komunalë për barazi gjinore në secilën prej komunave. Gjatë këtyre takimeve janë mbajtur prezantime, të cilat kishin fokus të drejtat e grave në ndarjen e pronës dhe në ofrimin e udhëzimeve se si ato të avokojnë për këto të drejta tek institucionet relevante.

“Në të ardhmen do të ndajmë pasurinë në mënyrë të barabartë për të dy fëmijët”, ka thënë një pjesëmarrëse në takimet e mbajtura në Komunën e Malishevës, ndërsa një tjetër ka thënë se “njohuritë mbi të drejtat në pronë do t’i përcjellin edhe tek vajzat e tyre”.

Fatime Limaj, po ashtu pjesëmarrëse në takime, ka sugjeruar që edhe fëmijët në shkollë të informohen mbi të drejtat e barabarta në pronë dhe trashëgimi pa dallim të gjinisë.

“Në këtë mënyrë do të bëhet vetëdijesim më i mirë prej moshës më të re, që të krijojmë një kulturë për të drejta të barabarta”, ka thënë ajo.

Këto takime gjithashtu kanë shërbyer që gratë dhe të rinjtë të informohen më shumë për raste konkrete. Në një nga takimet e mbajtura në Rahovec, gjykatësit civil të pranishëm, përfaqësuesit e zyrës për ndihmë juridike falas dhe zyrtarët për

barazi gjinore u janë përgjigjur në detaje pyetjeve të tyre lidhur me raste të konflikteve familjare kur gratë kanë dashur të regjistrojnë pronën në emrin e tyre.

Kjo iniciativë ka rezultuar shumë e suksesshme meqenëse, nga 60 gra dhe të rinjë të informuar për të drejtat që ju takojnë, shumë prej tyre kanë filluar të flasin hapur për të drejtat e tyre në pronë dhe trashëgimi përpara një audience më të gjerë, kurse për gratë që kanë qenë në vazhdim të procesit gjyqësor për të drejtat e tyre u është ofruar mundësia për t'i përdorur informatat e marra nga aktivitetet e organizuara. Ato, përveq tjerash, kanë theksuar rëndësinë e përfshirjes së të rinjëve dhe planfikojnë të vazhdojnë t'i shpërndajnë informatat e marra me të tjerët, sidomos me të rinjtë dhe të rejtat.

PEA kontribuon në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore

Mediat dhe raportet ndërkombëtare tregojnë që rastet e trafikimit me qenie njerëzore janë të shpeshta, por shtrohet pyetja se sa janë të informuar qytetarët e Kosovës për këtë çështje. Për këtë arsye organizata anëtare e RrGGK “Psikoterapeutët në Veprim (PEA)” nga Gjilani ka marrë iniciativën për të ngritur këtë çështje drejt parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore, me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,520€).

PEA ka organizuar shtatë punëtori ku pjesëmarrësit kanë zhvilluar debat aktiv dhe produktiv mbi trafikimin me qenie njerëzore. Ky debat ka rezultuar në vetëdijesimin e mbi 1000 vajzave dhe djemve nga komuna e Gjilanit.

“Më parë nuk e kemi ditur kujt t’i drejtohemi, kemi qenë të pa informuar”, është shprehur një prej pjesëmarrësve në trajnime.

Sipas Sevdije Musliut, Drejtore Ekzekutive e organizatës PEA, “pas trajnimeve dhe informatave që kanë marrë, gratë dhe vajzat ndjehen më të sigurta të flasin për problemet e tyre. Tani ato mund të iu drejtohen institucioneve për të treguar se çfarë iu ka ndodhur”.

Për të adresuar çështjen e mungesës së informatave të sakta rreth kësaj teme, PEA ka bashkëpunuar me radion lokale “Produksioni i Lirë”, ku Sevdije Musliu, ka folur për trafikimin me qenie njerëzore. Gjithashtu ajo ka shpjeguar se çka nënkupton ky fenomen, si ndodh dhe si duhet ta parandalojmë. Efekti i këtij



emisioni ka qenë shumë i suksesshëm, duke pasur parasysh që ky emision është transmetuar katër herë brenda pesë muajve.

PEA po ashtu ka organizuar një tryezë të rumbullakët, me përfaqësues të Komunës së Gjilanit, policisë, të Drejtorisë së Arsimit dhe nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), për të diskutuar dukurinë e trafikimit me qenie njerëzore, masat mbrojtëse dhe parandalimin e kësaj dukurie. Ky aktivitet ka rezultuar në përpilimin e disa rekomandimeve, përmes të cilave pastaj është avokuar tek institucionet përgjegjëse. Tashmë, organet shtetërore janë të vetëdijësuara për nevojën që ekziston mbi parandalimin dhe mbrojtjen e qytetarëve, sidomos të të rinjëve.

Edhe pse projekti ka përfunduar, organizata PEA ende vazhdon me aktivitetin e saj. Ndër të tjera, Drejtoria e Arsimit në Komunën e Gjilanit ka ftuar këtë organizatë për të bërë prezantime në shkollat e mesme gjatë ditëve të aktivizmit kundër dhunës në baza gjinore.

Gratë dhe vajzat e Dragashit dalin me hulumtim për qasjen në kujdesin cilësor shëndetësor

Gratë dhe vajzat e Komunës së Dragashit, për shkak se jetojnë në një territor mjaft të izoluar, atyre shpesh u pamundësohet edhe qasja në kujdesin cilësor shëndetësor, pasi që shumë shërbime nuk ofrohen fare. Por, së shpejti në fillim të vitit 2017, kjo komunë do të ketë një aparat mobil mamografie, ku dhe do të punësohet një mjekje në Qendrën Kryesore të Mjeksisë Familjare.

Nga qershori i vitit 2015, grave dhe vajzave të këtij rajoni, për herë të parë iu dha mundësia të shprehin pakënaqësitë e tyre lidhur me qasjen në shërbimet e kujdesit cilësor shëndetësor. Kjo u bë e mundur falë projektit “Gratë, shëndeti dhe e drejta e tyre ligjore”, implementuar nga Shoqata Iniciativa e Grave të cilat realizuan një hulumtim, mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,822€).

Fillimisht, përmes pjesëmarrjes në emisionet debatuuese, në radiot Sharri dhe Gora, ato njoftuan dhe informuan qytetarët e Komunës së Dragashit për nismën e një hulumtimi i cili do të trajtojë qasjen e grave në kujdesin cilësor shëndetësor. Aktivistet nga Komuna e Dragashit u trajnuan nga stafi i RrGGK mbi teknikat e hulumtimit, përzgjedhjen e mostrës dhe respektimin e saj. Përgjatë katër muajve, ato realizuan hulumtimin, ku anketuan 170 gra dhe vajza nga komunitetet shqiptare, gorane dhe boshnjake.

Më pas, u organizuan takime me zyrtarë komunal me qëllim të njoftimit të tyre mbi këtë hulumtim, si dhe për të nxitur bashkëpunimin në adresim të rekomandimeve të dala nga raporti hulumtues. Janë përgatitur fletushka dhe materiale të tjera informuese, të cilat kishin për qëllim të edukonin qytetarët me ligjet dhe të drejtat e tyre ligjore, me fokus në Ligjin për Shëndetësi dhe Kodin e Mirësjelljes.

“Projekti ka pasur ndikim shumë të madh në faktorin politik në komunë, që nënkupton edhe në drejtorinë e shëndetësisë në Komunën e Dragashit”, ka thënë Xhejrane Lokaj, drejtoreshë e Shoqatës Iniciativa e Grave.

Gjetjet kryesore të këtij hulumtimi tregojnë se vetëm 15,3% e grave dhe vajzave kanë njohuri rreth Ligjit për Shëndetësi. Vetëm 10% e grave dhe vajzave shfrytëzojnë institucionet publike shëndetësore, ndërsa prej tyre vetëm 6,47% janë të kënaqura me shërbimet shëndetësore të ofruara nga institucionet publike të shëndetësisë. Rreth 28,81 % e grave dhe vajzave preferojnë të trajtohen në ordinanca dhe klinika private duke e theksuar se këtu pranojnë trajtim më të mirë, koha e ofrimit të shërbimit është më e shkurtër si dhe besueshmëria më e lartë. Një problem tjetër i theksuar nga gratë dhe vajzat ishte edhe mungesa e aparaturës për diagnostifikim të kancerit, në veçanti mungesa e mamografisë. Bazuar në këto gjetje, Shoqata Iniciativa e Grave menjëherë filloi me avokimin tek komuna për sigurimin e një mamografi mobil për komunën e Dragashit. Komuna ka marrë vendim që një mamograf mobil të sigurohet më së voni në vitin 2017.

“Do e blejmë aparatën mobil për mamografi dhe pastaj do të vazhdojë iniciativa tjetër me sigurimin e radiologut. Jemi duke punuar në mënyrë intenzive. Aparatën mobil për mamografinë do e paguaj komuna, ky vendim është marrë”, ka thënë Xhejrane Lokaj.

Meqenëse në Qendrën Kryesore të Mjeksisë Familjare në komunën e Dragashit nuk ka pasur asnjë mjeke të punësuar, një nga kërkesat e grave ka qenë punësimi i një mjeke.

“E kemi rekomanduar në nivel lokal, ku është marrë parasysh dhe krytari i komunës ka premtuar se në gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 të punësohet një mjeke në komunën tonë”, ka shtuar ajo.

Organizata së bashku me gratë dhe vajzat përfituese do të vazhdojnë avokimin e tyre tek institucionet vendim-marrëse në nivel lokal dhe qendror. Sipas rekomandimeve të dala nga ky hulumtim, ato do të vazhdojnë të kërkojnë reforma në sistemin shëndetësor, aktivizimin e mekanizmave monitorues përmes inspektorëve, zbatimin e ligjeve që rregullojnë jetën dhe mirëqenien e qytetarëve, furnizimin me barëra në barnatore, si dhe jetësimin e shërbimeve këshillëdhënëse shëndetësore.

Gratë shqiptare dhe serbe bashkëpunojnë dhe fuqizojnë njëra tjetrën

Gratë nga fshatrat e Kosovës nuk janë mirë të informuara për të drejtat e tyre dhe mundësitë që ato kanë për pjesëmarrje në politikë dhe arritjen e pozitave vendim-marrëse. Dera e Hapur së bashku me organizatën Ruka Ruci, e panë të nevojshme të fuqizojnë sa më shumë gra përmes projektit “Fuqizimi i grave nëpërmjet krijimit dhe aktivizimit të dy grupeve të komuniteteve për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me të drejtat e grave dhe pjesëmarrjen në politikë dhe vendim-marrje”, mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës (me vlerë prej 7,590€).

Nga ky projekt i cili zgjati për gjashtë muaj, përfituan 450 gra dhe vajza të papuna, viktima të dhunës në familje dhe me aftësi të kufizuara. Qëllimi ishte që përveç fuqizimit të tyre të ofrohej edhe një hapësirë për bashkëpunim ndërmjet grupeve të ndryshme etnike si dhe të shohin problematikat që hasin ato. Prandaj, përfitueset vinin nga gjashtë fshatra të Kosovës: Hajvali, Bardhosh, Slivovë ku jetojnë vetëm shqiptarët; dhe



Bamirësi, Uglar dhe Graçanica ku jetojnë vetëm Serbët.

“Komunikimi midis grave nga komunitetet shqiptare dhe serbe, përfituese të këtij projekti, ka forcuar marrëdhëniet mes tyre. Ato kanë kuptuar që për të dyja palët ekziston i njeiti mentalitet ku ekzistenca e traditave të forta patriarkale, mungesa e arsimimit dhe mungesa e vetëbesimit, u pengon grave të kërkojnë të drejtat e tyre”, ka thënë Nevenka Rikallo, Drejtore e organizatës Ruka Ruci.

Të gjitha gratë pjesëmarrëse u informuan më detajisht mbi legjislacionin në fuqi, për t’ju ndihmuar në arritjen e synimeve të tyre dhe/apo në punën e tyre të përditshme. Krahas anës informative, u ofruan edhe mundësi në formë të trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve në avokim dhe komunikim që të kenë mundësi të përfshihen në mënyrë aktive në promovimin e të drejtave të grave si dhe të punojnë në një qëllim të përbashkët siç është barazia gjinore.

“Ne kurrë nuk kemi marrë pjesë në trajnime të tilla. Ndjehemi më të fuqizuara, pasi që po përfshihemi në mënyrë

aktive në të gjitha aktivitetet e organizuara,” u shpreh njëra nga pjesëmarrëset në trajnim.

Edhe përfaqësuesit e institucioneve, kanë mirëpritur këtë iniciativë. Zyrtarja për barazi gjinore në komunën e Graçanicës është shprehur se përfshirja e grave në zgjidhjen e problemeve të komunitetit do t'i vetëdijesoj ato për të drejtat e tyre, për kornizën ligjore dhe legjislacionin në fuqi në nivel qendror dhe komunal, si dhe për mënyrat se si këto instrumente ligjore të kthehen në favor të tyre.

“Këto iniciativa kanë inkurajuar gratë që jetojnë në zonat rurale dhe të izoluar, të fillojnë të ndryshojnë gjendjen e tanishme, për të kërkuar ndryshime si e drejtë e tyre”, ka thënë zyrtarja për barazi gjinore në komunën e Graçanicës.

Gjatë zbatimit të projektit janë krijuar grupe të grave të komuniteteve përkatëse, të cilat do të vazhdojnë të përfaqësojnë interesat e grave në nivel lokal dhe qendror. Përmes aftësive të përfituara për shërbimet dhe legjislacionin, ato do të vazhdojnë të shtyjnë përpara çështjet e grave në komunitetin ku veprojnë, si dhe do të ngrisin vetëdijen e grave dhe vajzave për të drejtat e tyre në mënyrë që të fuqizohen edhe më tutje.

Bashkëpuim më i mirë në mes të grave asambleiste në Kosovën veriore

Situata politike në Kosovën Veriore, më saktësisht në komunën e Mitrovicës së Veriut nuk e bën aq të lehtë bashkëpunimin e grave asambleiste në Veri me organizatat apo aktivistet për të drejtat e grave në pjesën tjetër të qytetit. Megjithatë, edhe pse me hapa të ngadaltë, Shoqata e Grave të

Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut (ShGMDN) ka gjetur një rrugë për të punuar me to.

Jo vetëm kaq, kjo organizatë, pas komunikimeve me to, ka vlerësuar që grave asambleiste nga komunat e Mitrovicës së Veriut, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit, përveq tjerash u mungojnë kapacitetet për avokim. Për të ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve të tyre në avokim dhe lobim si dhe për të zgjeruar njohuritë për Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSOKB), ShGMDN ka implementuar një projekt me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,545€). Po kjo organizatë, ka vazhduar me iniciativën e njejtë në vitin 2015, sërish me përkrahjen e Fondit (me vlerë prej 3,000€). Këto iniciativa janë vazhdimësi e aktiviteteve shumë të rëndësishme për këto gra.

Rreth 152 gra asambleiste kanë përfituar njohuri dhe më shumë informata nga trajnimet dhe takimet, që do t'ju shërbejnë për të kryer sa më mirë punën e tyre. Ksenija Bozovic, kryetare e komunitetit të katër komunave të Mitrovicës ka mbajtur një trajnim mbi Rezolutën 1325. Ato kanë pasur hapësirën të diskutojnë dhe të njoftohen me të gjitha mekanizmat e nevojshëm për zbatimin e Rezolutës 1325, rezolutë kjo e cila thekson rolin e rëndësishëm që gratë kanë në parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit, shpërndarjen e ndihmës humanitare, ndërtimin e paqes, bisedimet për paqen, ruajtjen e paqes, dhe në pajtimin gjatë kohës së pas konfliktit. Përmes kësaj iniciative, përveq kapaciteteve janë krijuar edhe lidhje dhe forma të bashkëpunimit në mes të gjitha asambleistëve nga katër komunat.

Gjithashtu ato kanë ngritur kapacitetet e tyre në komunikim, debat, prezantimit publik dhe aftësi udhëheqëse.

“Aftësitë e fituara ndihmuan asambleistet të kenë performancë më të mirë, të fuqizojnë pozicionin e tyre në mbledhjet e kuvendit, duke qenë më të dukshme dhe të thonë

mendimin e tyre në emisione televizive për votuesit”, Vetone Veliu, Drejtore Ekzekutive e ShGMDN.

Në takimet, të cilat janë organizuar krahas trajnimeve, gratë asambleiste kanë diskutuar për mundësitë për angazhimin tyre për të shtyrë përpara çështje me rëndësi për gratë. Për këtë, ato kanë punuar në detaje dhe kanë krijuar Planin Strategjik të Grupit të Grave Asambleiste i cili pasi të aprovohet nga komuna, mund të përdoret më tutje.

“Përmes takimeve mund të konkludojmë që ato treguan gatishmëri dhe mirëqenie për të punuar sipas ligjeve në Kosovë, por se ka ende disa shqetësime në lidhje me zbatimin dhe përputhshmërinë për punën e tyre në të ardhmen”, ka thënë Vetore Veliu.

Drejtorja e kësaj organizate, gjithashtu ka tentuar të nisë diskutime për formimin e Zyrës për Barazi Gjinore dhe rëndësinë e saj, duke zhvilluar intervista me përfaqësuesit e katër komunave, mirëpo për shkak të situatës politike siç është shprehur ajo “nuk ishin të gatshëm të flasin, sepse ata ishin të frustruar dhe të zemëruar se Prishtina ka depozituar krijimin e Asociacionit të katër komunave të veriut të Kosovës (Zajednica) dhe se nuk do të ketë asnjë diskutim për diçka më shumë, përfshirë Zyrën për Barazi Gjinore”.

Gratë asambleiste kanë zgjedhur lidere të grupit për secilën komunë, që ta kenë më të lehtë bashkëpunimin mes vete në të ardhmen. Edhe pse është e vështirë të shtyhen përpara çështjet e ngritura kur probleme madhore politike për Kosovën janë ende të pazgjidhura, ShGMDN nuk do ta ndalë punën dhe do të vazhdojë të tentoj që përmes grave asambleiste të trajtohen çështje të rëndësishme për gratë e Kosovës së Veriut dhe bashkëpunimi mes tyre të qëndrojë i fortë.

Personat me aftësi të kufizuara fuqizohen për t'u bërë aktivë brenda komuniteteve të tyre

Venera Leta është një vajzë që shkon në shkollën e mesme. Ajo ka distrofi muskulare, një gjendje shëndetësore kjo e cila dobëson muskujt, duke vështirësuar ecjen apo edhe lëvizjen e pjesëve të trupit.

'Është hera e parë që na ka vizituar dikush', u tha ajo përfaqësuesve nga Organizata e Personave me Distrofi Muskulare në Kosovë (OPDMK) kur ata shkuan për ta takuar atë. 'Deri tani, nuk ka ardhur askush, dhe kam pasur dëshirë që të përfshihem në shoqëri'.

Ndonëse njerëzit me aftësi të kufizuara përballen me shumë sfida në jetën e tyre, ndoshta një prej sfidave më frustruese është vetmia. Shumë persona me aftësi të kufizuara



në Kosovë nuk e kanë mundësinë të ndërveprojnë me njëri-tjetër jashtë familjes së tyre të ngushtë, sidomos me njerëz të tjerë me aftësi të kufizuara dhe që përballen me sfida të ngjashme. Kjo është njëra prej çështjeve që është diskutuar në doracakun e ri të titulluar "Shoqëria dhe qasja e saj për personat me aftësi të

kufizuara”.

‘Ndonjëherë është e vështirë të vendosësh nëse do të ngrihesh nga shtrati për të marrë pjesë në ndonjë takim, ku patjetër të duhet ndihmë nga dikush tjetër, ose thjesht të mos ngrihesh’, thuhet në fillim të doracakut, ku citohet një aktivist me distrofi muskulare. ‘Që të mund të jem aktiv, dikush duhet të më ndihmojë gjithmonë që të ngrihem nga shtrati, të vishem, të më vërë në një karrocë me rrota dhe të më çojë në takime’.

Doracaku merret me hapat e nevojshëm për krijimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim që ata të mund të përfshihen më shumë në shoqëri. Ky doracak është përgatitur nga OPDMK-ja, organizatë në Prizren, e cila drejtohet nga persona me distrofi muskulare dhe punon me këta persona.

Arben Shala, këshilltar në OPDMK, ka thënë se në këtë doracak adresohen shumë çështje dhe tabu. Për shembull, disa persona me aftësi të kufizuara presin që një ditë të jenë në gjendje të krijojnë familje, ndryshe nga ajo që besojnë shumë njerëz në shoqëri.

Me anë të publikimit të këtij doracakut dhe bërjes së vizitave te personat me aftësi të kufizuara, OPDMK-ja ka kërkuar të qartësojë se pavarësisht sfidave me të cilat përballen, personat me aftësi të kufizuara mund të përfshihen në shoqëri. Gjatë kësaj nisme, OPDMK-ja, në partneritet me organizatën tjetër, Gratë Vizionare të Shekullit XXI, nga Hasi, ka synuar të përmirësojë pozitën e grave që ofrojnë përkujdesje në familje dhe anëtarëve me aftësi të kufizuara në familje. Ata kanë vizituar shumë familje anëtarët e të cilave janë me aftësi të kufizuara dhe u kanë ofruar ndihmë si: materiale sanitare, ushqime, strehë dhe mjete ortopedike. Megjithatë, ajo për të cilën familjet kishin më së shumti nevojë ishte që dikush të vinte e t’i vizitonte.

‘Deri tani, përveç nesh, as edhe një shoqatë apo

institucion nuk i ka vizituar', tha Resmije Rahmani nga OPDMK-ja, aktiviste e cila ka distrofi muskulare edhe vetë. Një prej gjërave më të mira të vizitave ishte se këto bësheshin nga njerëz me aftësi të kufizuara, tha ajo. Tashmë, familjet që ata vizituan, e dinë se ekzistojnë mundësi që anëtarët e familjes së tyre të dalin jashtë shtëpisë, të udhëtojnë dhe të jenë pjesë aktive e shoqërisë. 'Pas këtyre vizitave, ata tani po kërkojnë të jenë pjesë e çdo takimi dhe aktiviteti', tha Rahmani.

Gjatë vizitave, OPDMK-ja ka kryer edhe hulumtime, duke iu kërkuar familjeve të plotësojnë një pyetësor.

'Personave që ofrojnë përkujdesje dhe personave me distrofi muskulare u janë dhënë pyetësorë të ndryshëm', tha Antigona Shestan, Drejtoreshë Ekzekutive e OPDMK-së. 'Megjithatë, fakti se ka pasur mungesë koherence në pohimet nga prindërit apo personat që ofrojnë përkujdesje dhe pohimeve që janë bërë nga personat me distrofi muskulare lidhur me nevojat dhe probleme të tyre, ka ngritur shqetësime'. Ende mbetet shumë për të bërë, u shpreh ajo.

Për shembull, në disa raste, organizatat partnere kanë konstatuar raste ku personat me aftësi të kufizuara janë izoluar plotësisht nga shoqëria, tha Marte Prenkpalaj, drejtore e Grave Vizionare të Shekullit XXI. 'Shumica e njerëzve që vuajnë nga kjo gjendje shëndetësore nuk shkojnë as në shkollë', tha ajo. 'Ata rrinë të mbyllur e të izoluar në shtëpitë e tyre. Ky problem duhet t'i raportohet Ministrisë së Arsimit'.

Duke u mbështetur në gjetjet nga pyetësorët dhe duke përdorur doracakun, OPDMK-ja dhe Gratë Vizionare të Shekullit XXI e kanë identifikuar këtë çështje si një prej pikave të tjera të avokimit. Ata informuan qeverinë vendore të Prizrenit dhe qytetarët lidhur me problemet me të cilat përballen personat që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara, duke bërë thirrje për marrjen e veprimeve që do t'ua përmirësonin

jetën. Ata gjithashtu diskutuan pensionet për personat me aftësi të kufizuara, jo vetëm për personat që kujdesen, sepse shumë njerëz me aftësi të kufizuara kanë shprehur shqetësime se çdo ditë ata mund të mbeten pa personat që kujdesen për ta dhe do të kenë nevojë për përkrahje financiare.

Në fund, ndoshta suksesi më i madh i nismës së përkrahur nga Fondi i Grave të Kosovës (7,827€) ishte se ai i vuri në dijeni personat me aftësi të kufizuara se ata nuk janë vetëm dhe i fuqizoi ata që të bëheshin më aktive për të avokuar për të drejtat e tyre. 'Personat që janë vizituar në kuadrin e këtij projekti janë bërë aktivistë dhe tani mund të kontribuojnë në komunitetet e tyre', u shpreh Shala.

Gjilani dhe Vitia fillojnë institucionalizimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor

Në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor (BPGJ) përfshihet kujdesi që perspektiva gjinore të inkorporohet gjatë gjithë procesit të buxhetimit në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e përdorimit të shpenzimeve publike. Me anë të tij, ofrohet një mënyrë më e barabartë, më efektive, efikase dhe transparent e planifikimit dhe ekzekutimit të buxheteve qeveritare. Ligji i ri i Kosovës për Barazinë Gjinore (2015) e ka bërë BPGJ-në detyrim ligjor për të gjitha organizatat buxhetore në Kosovë, duke përfshirë komunat. Më tej, Qarkorja Buxhetore nr. 2017/01, e cila është shpërndarë nga Ministria e Financave në qershor të vitit 2017, i ka inkurajuar të gjitha komunat që ta integrojnë BPGJ-në në buxhetet e tyre vjetore.

Megjithatë, BPGJ-ja është një koncept mjaft i ri si në Kosovë ashtu edhe në vende të tjera. Që prej fillimit të vitit 2016, të pakta ishin organizatat buxhetore në Kosovë që kishin filluar të zbatonin këtë detyrim ligjor, duke përfshirë këtu edhe komunat e Vitisë dhe të Gjilanit. Për këtë arsye, Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “Liria” në Gjilan dhe organizata jo-qeveritare “Legjenda” në Viti, vendosën të krijojnë një ekip të përbashkët me qëllim që të çonin përpara procesin e institucionalizimit të BPGJ-së në komunat e tyre.

Të përkrahura nga Fondi i Grave të Kosovës (7,780€), këto anëtare të RrGGK-së filluan duke bërë organizimin e takimeve informuese me anëtarët e asamblesë komunale, anëtarët e Lobit Kosovar për Barazi Gjinore dhe me gra të tjera aktive në komunitetet e tyre. Ata shpjeguan konceptin e BPGJ-së dhe i bindën për rëndësinë që ai ka.

‘Më parë ata mendonin se koncepti i referohej vetëm njëres gjini’, tha Melihate Osmani, koordinatore e projektit të “Legjendës” në terren. ‘Tani ata e dinë se gjatë planifikimit të buxhetit, buxheti duhet të ndahet duke u mbështetur në [nevojat e] të dyja gjinive’.

Në fakt, BPGJ-ja mbështetet në analizat gjinore për të identifikuar nevojat e grave dhe burrave të ndryshëm, që synohen sipas programeve të ndryshme qeveritare, duke siguruar që këto programe të dizajnohen për të plotësuar më mirë nevojat dhe interesat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave.

Më pas, “Legjenda” dhe “Liria” kontraktuan një ekspert të BPGJ-së, i cili dha një cikël trajnimesh në Gjilan dhe Viti, ku morën pjesë 147 njerëz. Pjesëmarrës ishin zyrtarë të financave, zyrtarë për barazi gjinore, drejtorë të drejtorive komunale dhe anëtare të kuvendit komunal. Trajnuesi theksoi rëndësinë që ka

kryerja e hulumtimit përpara planifikimit të buxheteve dhe sigurimit të mbledhjes së të dhënave të ndara sipas gjinive.

Meqenëse Komuna e Kamenicës ka arritur disa suksese revolucionare në drejtim të integritit të BPGJ-së në dokumentet dhe proceset e tyre buxhetore, partnerët e projektit i ftuan përfaqësuesit e komunës që të ndanin përvojën e tyre. Zyrtarët nga Gjilani dhe Vitia mësuan shumë nga përvoja e Kamenicës në integrimin e BPGJ-së në Kornizën e tyre Afatmesme të Buxhetit.

Këto takime dhe trajnime kanë përmirësuar në mënyrë efektive vetëdijesimin lidhur me BPGJ-në në radhët e institucioneve kryesore dhe të udhëheqësve lokalë, të cilët mund t'u kërkojnë llogari institucioneve lidhur me zbatimin e përgjegjësive të tyre ligjore që kanë të bëjnë me BPGJ-në. Pas këtyre takimeve, disa anëtarë të asamblesë shprehën verbalisht zotimin e tyre për ta çuar më tutje barazinë gjinore në komunat e tyre.

'Projekti ishte shumë i suksesshëm', tha Nazife Jonuzi, drejtore ekzekutive e "Lirisë", 'meqenëse fare të paktë ishin zyrtarët që ishin të informuar për BPGJ-në më përpara [apo] se çfarë nënkuptonte ky. Dhe fare pak prej tyre e kishin zbatuar më përpara në aspektin praktik në institucionet e tyre'.

Edhe pse do të duhet kohë për ndryshimin e qëndrimeve, çuarjen më tej të kapaciteteve dhe institucionalizimit e qëndrueshëm të BPGJ-së, kjo nismë ka pasur disa suksese të suksesshme fillestare. Së pari, nisma ua ka rritur vetëdijesimin zyrtarëve dhe aktivistëve në këto dy komuna lidhur me BPGJ-në, atë se çfarë nënkupton ky koncept dhe mënyrën se si ta zbatojnë atë në komunat e tyre. Së dyti, Komuna e Gjilanit mori vendim të fillonte të inkurajonte gratë që të aplikojnin kur të hapeshin vende pune për nëpunës civilë. Për sa i takon sigurimit të baraspeshimit të shpenzimeve publike për gratë dhe burrat dhe rritjes së barazisë gjinore brenda

shërbimit civil dhe në proceset e vendimmarrjes, ky veprim afirmativ përbën një hap të rëndësishëm drejt çarjes më tej të barazisë gjinore. Këto veprime afirmative parashikohen në Ligjin për Barazi Gjinore, edhe pse deri më sot fare pak institucione i kanë përdorur ato. Me këtë vendim zyrtar, Komuna e Gjilanit është duke krijuar një shembull shumë pozitiv nga i cili mund të mësojnë komunat e tjera dhe institucionet e nivelit qendror. Së tregi, ky veprim ka fuqizuar bashkëpunimin midis dy organizatave të cilat planifikojnë të vazhdojnë avokimin në drejtim të institucionalizimit të qëndrueshëm të BPGJ-së në komunat e Gjilanit dhe Vitisë.

Skenderaj i bashkohet nismës “Së bashku kundër dhunës në familje”

Në Kosovë, dhuna në familje përbën krim. Pavarësisht kësaj, në aspektin shoqëror, shumë njerëz në Kosovë e konsiderojnë dhunën në familje si një çështje private e cila duhet të zgjidhet brenda familjes – sipas hulumtimit të kohëve të fundit të titulluar “Mjaft më me arsytimë”, të realizuar nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK). Për rrjedhojë, aktet kriminale të dhunës në familje nuk raportohen gjithmonë. Gjithashtu, disa njerëz nuk dinë se si t'i raportojnë rastet e dhunës në familje. Kur këto raste raportohen, institucionet nuk e kanë përshpejtuar reagimin më të koordinuar të mundshëm në lidhje me asistimin dhe fuqizimin e të mbijetuarave të dhunës në familje.

Qendra e Grave “Prehja”, organizatë anëtare e RrGGK-së, ka pasur si shqetësim të saj shkallën në të cilën gratë dhe vajzat që vuajnë nga dhuna në familje në komunën e tyre, Skenderaj, kanë qasje në mbështetjen institucionale. Prandaj, me një grant

nga Fondi i Grave të Kosovës (2,938€), gjatë periudhës nëntor 2016 - shkurt 2016, anëtarët e qendrës janë takuar me 1850 gra, vajza, burra dhe gra në komunat e tyre, duke u dhënë atyre fletëpalosje ku kishte informata lidhur me Ligjin kundër Dhunës në Familje dhe procedurave gjyqësore të cilat duhet të ndiqen në rastet e dhunës në familje. Gjatë takimeve me gratë dhe vajzat, “Prehja” identifikoi përafërsisht 200 vajza dhe gra nga zonat rurale, të cilat ishin përballur me dhunë fizike, psikologjike apo forma të tjera të dhunës dhe iu ofruan atyre ndihmë për të siguruar përkrahjen institucionale.

Sipas “Prehjes”, gratë dhe vajzat në zonat rurale të Skenderajt tani janë “më të informuara dhe të lira të adresojnë problemet me të cilat përballen”, u shpreh Iliriana Shala, koordinatore e projektit. ‘Tani, ato do të jenë më të sigurta kur raportojnë rastet e dhunës’.

Më tej, “Prehja” ka avokuar me sukses te institucionet komunale për të ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të përmirësimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe të adresimit më të mirë të dhunës në familje. “Prehja” ka punuar së afërmi me kuvendin e Komunesë së Skenderajt, i cili ka krijuar dhe miratuar strategjinë e re kundër dhunës në familje për komunën e tyre.

Gjithashtu, pas punës avokuese të “Prehjes”, institucionet komunale duke përfshirë Drejtorinë e Administratë, Zyrën e Barazisë Gjinore, Zyrën për të Drejtat e Njeriut dhe Qendrën për Punë Sociale, janë angazhuar të gjitha që të ofrojnë përkrahje për adresimin e situatave të dhunës në familje. Koordinimi është përmirësuar edhe mes policisë, prokurorisë dhe gjykatave në lidhje me adresimin e rasteve të dhunës në familje. Si rezultat i kësaj nisme, ata kanë përsheptuar reagimin e tyre, duke siguruar që rastet e dhunës në familje të mos mbyllen pa njoftimin e gjykatës ose prokurorisë.

Për të lehtësuar monitorimin e punës së gjykatave dhe qasjen e grave në drejtësi, “Prehja” ka lidhur një marrëveshje edhe me degën e Gjykatës Komunale të Mitrovicës, në Skënderaj, me anë të së cilës gjykata i ofron rregullisht informata organizatës lidhur me numrin e rasteve të dhunës në familje. Me këto përditësime të vazhdueshme lidhur me rastet, “Prehja” është në gjendje të monitorojë seancat e gjykatave, në funksion të çuarjes përpara të qasjes në drejtësi në rastet e dhunës në familje.

Edhe pse përkrahja financiare e Fondit të Grave të Kosovës ka përfunduar, “Prehja” ka baza të forta për adresimin e dhunës në familje brenda komunës ku vepron dhe përfitimet e kësaj do të jenë të qëndrueshme në të ardhmen. Përtej rritjes së vetëdijesimit në radhët e grave dhe fuqizimit të koordinimit midis institucioneve, “Prehja” ka arritur një marrëveshje me Komunën e Skënderajt përmes së cilës organizata do të vazhdojë të marrë pjesë në zbatimin e Strategjisë Komunale kundër Dhunës në Familje. Në këtë mënyrë, “Prehja” do të vazhdojë të punojë me autoritetet komunale për të zvogëluar rastet e dhunës në familje në të ardhmen.

Qytetarët e Pejës bashkohen për t'i dhënë fund dhunës në baza gjinore

‘Nuk do ta lejoj shoqen time të dalë jashtë me fund të shkurtë’, tha një djalë.

‘Është në rregull që babai ta godasë nënën’, tha një djalë tjetër.

Këto ishin disa nga komentet e bëra nga të rinjtë të moshës 14 deri në 15 vjeç, kur Qendra për Mirëqenien e Gruas (QMG) kishte filluar takimin me nxënës në Komunën e Pejës.

'Këto komente janë shqetësuese', tha Drejtoresha Ekzekutive e QMG-së Ardita Ramizi Bala, 'sidomos duke pasur parasysh faktin se nxënësit kishin bërë komente të tilla'. Qëndrime të tilla inkurajojnë fëmijët që të jenë të dhunshëm, si dhe ta pranojnë dhunën, tha ajo. Nëse në mesin e fëmijëve ekzistojnë besime të tilla, kjo tregon se shumë punë mbetet për t'u bërë lidhur me këtë çështje në shoqërinë më të gjerë.

Në të vërtetë, dy raportet e publikuara në kohë të fundit nga Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës me titull *Ngacmimi Seksual në Kosovë* dhe *Mjaft më me arsytetime*, në lidhje me dhunën në familje, kanë dëshmuar se pikëpamjet e këtyre të rinjve janë mjaft të përhapura në tërë shoqërinë kosovare. Kjo është pjesë e arsyes që QMG-ja ka hyrë në klasa, duke kërkuar që të edukojë të rinjtë rreth dhunës në baza gjinore, drejt transformimit të qëndrimeve të cilat mundësojnë që dhuna të ndodhë.

Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (2,980€), QMG-ja u angazhua që ta rrisë vetëdijen në komunitetin e tyre për pasojat e dhunës në baza gjinore, duke përfshirë nxënësit, përfaqësuesit e institucioneve komunale dhe drejtorët e shkollave. Përmes trajnimeve, diskutimeve dhe prezantimeve në shkolla, ata arritën te 280 studentë, si dhe 60 gra dhe burra në Komunën e Pejës me informata në lidhje me dhunën në familje. Ata gjithashtu prezantuan informata në lidhje me format e ndryshme të dhunës në Radio Dukagjini dhe Radio Peja, duke u sqaruar qytetarëve se çfarë shkakton dhuna fizike, emocionale, psikologjike dhe ekonomike.

Më tej, në përpjekje për t'u siguruar shërbime më të mira dhe më të shpejta grave që vuajnë nga dhuna, QMG-ja organizoi dy tryeza të rrumbullakëta diskutimi me përfaqësues të institucioneve të ndryshme që punojnë me personat që kanë pësuar dhunë në familje.

'Ne si organizatë kemi një strehimore ku mund të shkojnë gratë dhe fëmijët që janë viktima të dhunës në familje', tha Ramizi-Bala. Përvoja e tyre e gjatë e punës në strehimore me gratë dhe fëmijët që kanë përjetuar dhunë u ka siguruar atyre njohuri të hollësishme në lidhje me sfidat që ballafaqohen personat që vuajnë nga dhuna, si dhe mangësitë e institucioneve. Përmes takimeve me institucionet, ata kërkuan që të përmirësojnë qasjen institucionale në përputhje me kuadrin ekzistues ligjor, në drejtim të sigurimit të mbrojtjes dhe të sigurisë për personat që vuajnë nga dhuna.

Tani, si rezultat, institucionet i kuptojnë më mirë përmirësimet e nevojshme për t'u siguruar shërbime më të mira grave dhe fëmijëve që kanë përjetuar dhunë. Një rezultat i rëndësishëm i kësaj nisme është që institucionet e arsimit tani e kuptojnë më mirë detyrën e tyre për t'i njohtuar autoritetet përkatëse lidhur me çdo rast të dhunës në familje që u janë raportuar atyre. Zyrtarët janë përkushtuar që të punojnë më shumë me profesorët dhe mësuesit në identifikimin e rasteve të dhunës, me qëllim të ndërhyrjes së hershme dhe parandalimit të dhunës shtesë.

Përveç kësaj, nisma e QMG-së ka vetëdijësuar opinionin se gratë kanë nevojë për mbështetje, jo vetëm nga institucionet, por gjithashtu edhe nga shoqëria. Duke e kuptuar më mirë dhunën në familje u mundëson nxënësve të jenë më vigjilentë dhe i bën ata më të vetëdijshëm se si t'i raportojnë rastet e dhunës, veçanërisht si t'i ndihmojnë miqtë e tyre apo anëtarët e familjes në qoftë se ata janë duke përjetuar dhunë në familje. Në përgjithësi, komuniteti është më i vetëdijshëm lidhur me strategjitë për krijimin e një kulture jo dhunuese, në mënyrë që çdo anëtar i shoqërisë së tyre të mund të ndjehet i sigurt.

Gratë në zonat rurale mësojnë për shëndetin riprodhues

Shëndeti riprodhues mbetet një temë mjaft tabu në diskursin publik. Kjo nuk është diçka për të cilën njerëzit flasin. Edukimi i pamjaftueshëm në lidhje me shëndetin riprodhues duket se i kontribuon përdorimit të ulët të kontraceptivëve dhe shkallës së lartë të abortit në Kosovë për shkak të shtatzënive të paplanifikuara, është konstatuar në kërkimin e fundit nga Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RrGGK).

Mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës (7,190€), Shoqata për Edukim dhe Përkujdesje Familjare (AEFC) dhe organizata Gruaja Hyjnore bashkëpunuan për të



ngritur vetëdijen në lidhje me shëndetin riprodhues, duke mbajtur 48 punëtori në komunat e Gjakovës dhe Gjilanit. Nëpërmjet këtyre takimeve, 441 gra dhe vajza të moshës 11 deri 55 nga tetë fshatra fituan njohuri në lidhje me shëndetin dhe masat mbrojtëse riprodhuese, duke përfshirë ato kundër sëmundjeve seksualisht të transmetueshme. Pasi ato erdhën nga zonat e largëta, shumë nga pjesëmarrëset kishin ndërprerë shkollimin e tyre pas shkollës fillore, kështu që ato nuk kanë marrë asnjë dijeni formale lidhur me shëndetin riprodhues çfarëdo qoftë ai. Kjo ishte hera e parë.

Organizatat partnere u konsultuan me gratë në lidhje me ndonjë përvojë të mëparshme që kishin pasur gjatë vizitës te gjinekologu apo gjatë përdorimit të metodave të ndryshme

kontrceptive. Edhe burrat janë anketuar. Ata konstatuan se përgjigjet ishin shumë shqetësuese.

'Vajzat nuk kryejnë kontrolle gjinekologjike për shkak të paragjytimeve', thanë pjesëmarrësit gjatë takimeve. Disa mund të vizitojnë klinikat private në mënyrë që identiteti i tyre të mbahet i fshehtë, thanë ata. Megjithatë, jo të gjithë mund të përballojnë t'i vizitojnë klinikat private. Kjo mund të thotë që disa gra të reja nuk kanë marrë informata në lidhje me shëndetin riprodhues ose opsionet e planifikimit familjar.

Kjo iniciativë u ofroi atyre mundësinë që të mësojnë më shumë rreth këtyre temave në një hapësirë të sigurt. Gratë dhe vajzat e përfshira në iniciativë thanë se ishin shumë të kënaqura, sepse ato asnjëherë më parë nuk kishin marrë informata të tilla. Ato thanë se do t'ua transmetojnë njohuritë që i fituan vajzave dhe grave e tjera që nuk ishin të pranishme.

***Naš Dom* mbështet iniciativën e buxhetimit gjinor**

Katër komunitet me shumicë serbe, ajo e Kllokotit, Novobërdës, Parteshit dhe Shtërpçës, i kanë ndërmarrë hapat e parë drejt prezantimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në komunitet e tyre.

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) është një detyrim i ri ligjor në Kosovë në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore. Megjithatë, shumë pak zyrtarë brenda këtyre komunave kanë pasur njohuri për këtë koncept dhe as se si të institucionalizohet BPGJ-ja në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit të tyre.

Për këtë arsye, Shoqata e Grave *Nas Dom* ndërmori një iniciativë të mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës (2936€) drejt ngritjes së vetëdijes lidhur me Ligjin për Barazi Gjinore dhe këtë detyrim të ri ligjor. *Nas Dom* gjithashtu u angazhua të gjejë mënyra për përfshirjen më të madhe të grave në shoqëri. Aktivistët e *Nas Dom* kërkuan që të përmirësojnë bashkëpunimin në mes të qeverisë lokale dhe organizatave joqeveritare, duke organizuar takime mes grave anëtare të kuvendit, aktivistëve nga organizatat joqeveritare, punonjësit në administratën publike, udhëheqësit e pushtetit vendor dhe mediet. *Nas Dom* trajnoi një kuadër të vullnetarëve për të monitoruar aktivitetet e qeverive të tyre lokale, duke përfshirë zyrtarët për barazi gjinore.

Së bashku, ata organizuan katër punëtori tre-ditore në katër komuna duke u fokusuar në Ligjin për Barazi Gjinore, se si ta promovojnë atë dhe rëndësinë e krijimit të një plani të veprimit për integrimin e BPGJ-së në nivel lokal. Gjatë këtyre takimeve, ata ngritën vetëdijen e më shumë se 200 njerëzve në lidhje me Ligjin për Barazi Gjinore dhe rëndësinë e BPGJ-së. Ata gjithashtu identifikuan së bashku sfidat kryesore për të siguruar që zyrat për barazi gjinore të jenë funksionale në nivel komunal. Pasi vetëm pak qytetarë apo zyrtarë e kishin diskutuar ndonjëherë këtë temë më parë, ata e konsideruan atë shumë të rëndësishme dhe të suksesshme.

"Nisma të tilla janë shumë pozitive, por këto procese dhe puna në drejtim të tyre në komunat tona duhet të jenë të pandalshme për të arritur qëllimin tonë afatgjatë", tha një pjesëmarrës. 'Me punë dhe përkushtim, barazia gjinore mund të arrihet shumë lehtë në të gjitha komunat, pasi Ligji për Barazinë Gjinore garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive'.

Gratë vetëdijesohen për sëmundjen e osteoporozës

Sipas Asociacionit për Osteoporozë të Kosovës (ASOK), llogaritet se rreth 150000 persona vuajnë nga osteoporozja në Kosovë. Është vërejtur që shumë zona rurale ballafaqohen me probleme të shumta dhe hasin në pengesa për qasje në shërbime shëndetësore, sa i përket kësaj sëmundjeje. Shoqata e Grave Pensioniste Vita-Jeta me përkrahjen e Fondit të Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,965€), ka marrë përsipër ofrimin e qasjes për gratë në shërbime shëndetësore më të specializuara dhe ofrimin e kontrolleve falas, përfshirë ngritjen e vetëdijes së tyre për parandalimin dhe trajtimin e kësaj sëmundjeje.

Për herë të parë, në fshatrat si Llajshevc, Makovci, Bardhoshi, Besia dhe Hajvalia, Vita-Jeta së bashku me Specialistin e Reumatologjisë, Dashurie Kryeziu, përmes takimeve kanë mbajtur ligjërata për parandalimin dhe trajtimin e kësaj sëmundjeje.



Atyre u janë shpërndarë broshura informative dhe edukuese. Ato poashtu kanë ofruar terapi trajtuese për të sëmurët si dhe kontrolle mjekësore falas.

Gratë janë shprehur falenderuese për aktivitetet që janë zhvilluar pasi që u mundësohet grave të bëjnë ekzaminime falas dhe të mësojnë më shumë rreth sëmundjes.

“Gjithmonë na mundësojnë që të kemi takime me doktoresha dhe psikologe, të cilat na këshillojnë për shumë sëmundje nga të cilat ne gratë pensioniste mund të prekemi, por edhe t’i mjekojmë ato”, ka thënë Lutfije Zeneli, pensioniste dhe anëtare e Vita-Jeta.

Sipas analizave të bëra me gratë anëtare të Vita-Jeta, del se 30% të rasteve ishin me osteoporozë; 45.6% janë në stadin për t’u zhvilluar osteoporozë (osteopeni); kurse vetëm një e katërta e tyre janë në gjendje normale të dendësitetit të eshtrave. Kjo do të thotë që çdo e treta grua mbi moshën 50 vjeçare vuan nga osteoporozë.

Doktoresha Dashurie Kryeziu, e cila gjithmonë ofron kontrolle falas për gratë në kuadër të organizatës, ka bërë analizën e dendësisë së eshtrave me anë të osteodenzitometrit (DXA aparatit) në thembër të këmbës, si dhe ka analizuar se cilat gra janë me osteoporozë dhe cilat me osteopeni (të rrezikuara nga kjo sëmundje). Ajo po ashtu ka analizuar çdo gjë që ka të bëjë me profilaksën edhe trajtimin e kësaj sëmundje.

Meqenëse interesimi dhe nevoja ishte shumë e madhe, më shumë se 315 gra përfituan nga kjo iniciativë. Ato tani ndjehen të vetëdijesuara dhe të përgaditura për tu përballur me këtë sëmundje.

“Kjo mund të ketë ardhur si shkak i aktiviteteve dhe vetëdijesimit që kemi bërë për këtë sëmundje ne projektet e mëparshme”, ka thënë Mimoza Nuhiu-Ajeti, Drejtore Ekzekutive e Vita-Jeta.

Me rezultatet e analizave të grave, Vita-Jeta ka avokuar në Ministrinë e Shëndetësisë që aparatúra e osteodenzitometrit (DXA aparatit) të vendoset nëpër të gjitha qendrat shëndetësore në rajon në mënyrë që kjo analizë të bëhet nga sa më shumë gra dhe burra. Sa i përket interesimit nga vajzat e reja, ai ka qenë më i madh meqenëse ato po informohen nga

familjarët apo të afërmit e tyre, që të bëjnë analizën e osteoporozës. Gjithashtu, nga analizat e bëra është vërejtur që në qytete, përqindja e kësaj sëmundje ka qenë më e lartë se në fshatra e kjo mund të jetë si rezultat i konsumimit të ushqimit më natyral.

Rikotta dhe Shoqata e Grave Gora bashkëpunojnë për të drejtat e grave në pronësi

“Një ditë, shkuam tek një familje dhe burri filloi t’i binte tavolinës dhe të thoshte ‘kush jeni ju që t’i tregoni gruas time për pronë... pas shumë viteve ju po doni të më ndani nga gruaja e cila nuk din as lexim e as me fol, e ju po i tregoni që ajo duhet të lypë pronë nga unë”, tregon përvojën e saj Sevdija Ramadani, Drejtore Ekzekutive e organizatës Gora.

Organizata Gora në bashkëpunim me organizatën Rikotta, kanë ndërmarrë iniciativën për të drejtat e grave në pronë me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (me vlerë prej 5,862€). Ato kanë identifikuar gratë që t’i vetëdijesojnë dhe tu ndihmojnë atyre për të kërkuar të drejtat që ju takojnë.

Gjendja e grave në ato fshatra është shumë e rëndë, ku shumica e tyre nuk dinë as shkrim dhe lexim, sidomos komuniteti goran. Rikotta dhe Gora janë organizatat e para që kanë vizituar fshatrat Gornjeselo, Mushnikovë, Sredska, Bogoshev dhe



Reqan. Ato kanë shkuar derë më derë për t'u takuar me gratë e familjeve, me të cilat kanë biseduar dhe u kanë dhënë hapësirën të ndajnë përvojat e tyre.

“Ka pasur gra që nuk pranuan të jenë pjesë e kësaj iniciative, por më së shumti problem na kanë shkaktuar burrat e tyre dhe vjehrrit, ku 6 raste na kanë përzënë nga dera dhe nuk kanë lejuar t'i takojmë gratë”, ka spjeguar Pranvera Bullaku, Drejtore Ekzekutive e Rikotta.

Gratë gjatë aktiviteteve kanë pasur mundësinë që poashtu të diskutojnë me Drita Rexhepin, zyrtare nga agjencia për ndihmë juridike falas në Kosovë, e cila ju ka folur mbi të drejtën e tyre në pronë të përbashkët dhe në trashëgimi familjare.

Përmes kësaj iniciative, është vërejtur dëshira e grave për fuqizim ekonomik. Ato janë shprehur që janë shumë të interesuara të përfshihet apo të punojnë direkt me prodhimin dhe shitjen e produkteve të tyre bujqësore”, tha Pranvera Bullaku.

Puna me këto gra kishte sfidat e veta, mirëpo këto dy organizata nuk janë ndalur. Ato vetëm kanë vazhduar të gjejnë mënyra se si t'i fuqizojnë më shumë gratë dhe nuk do të ndalen së punuari derisa të arrijnë qëllimin e tyre.

“Venera” avokon mbi të drejtën e gruas në pronë

Miradije Sheremeti, drejtore e organizatës Venera që kur ka qenë nxënëse, ka pasur ëndërr dhe qëllim që të punojë për të drejtat e gruas dhe të drejtat e tyre në pronë. Edhe pse kanë kaluar shumë vite, çështjet juridike janë ende problem për të drejtat e gruas në pronë dhe trashëgimi.

Kështu, Venera ka organizuar takime me gratë për t'i njoftuar me të drejtën ligjore mbi ndarjen e pronës, qoftë si pronë e fituar nga trashëgimia apo pronë e fituar nga kontributi i përbashkët martesor, si dhe për t'i informuar rreth mbrojtjes së të drejtës mbi pronën.



Duke qenë dhe vetë pjesë e këtij problemi, Miradija punon dhe lufton që gratë të fitojnë atë që u takon dhe të vetëdijesohen për këto të drejta, si gratë ashtu dhe burrat. Mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,944€), 62 gra nga Peja dhe fshatrat përreth, përfituan dijeni nga tryezat për diskutim të organizuara nga Venera.

Nga kjo iniciativë, shtatë gra kanë inicuar procedurat për ndarje të pronës, ndërsa një grua ka arritur që të bëhet pronare e pronës. Gima Ahmeti është gruaja e cila ka marrë çertifikatën e regjistrimit në pronë për trashëgimi, megjithatë e gjithë kjo nuk ka ardhur pa probleme pasi që e gjithë kjo procedurë i ka ndikuar negativisht në marrëdhëniet familjare.

“Është një shembull shumë i mirë i një gruaje të fortë, të cilës burri vazhdimisht i thoshte të hiqte dorë ndersa vëllezërit e motrat e saj e kanë dëbuar nga familja dhe nuk flasin fare me të. Edhe pse e përballur me keqtrajtme nga gjykata dhe komuna, ajo e arriti qëllimin e saj dhe e vuri në praktikë të drejtën që i takon”, ka thënë Miradije Sheremeti, e cila vazhdimisht i ka qëndruar pranë dhe e ka ndihmuar gjatë procedurave bashkë me organizatën e saj.

Rastit të Gima Ahmetit dhe shumë rasteve të tjera, Venera vazhdon si para dhe pas projektit t'u ofrojë ndihmë profesionale juridike falas për procedurat administrative dhe gjyqësore lidhur me ndarjen e pronës tek gratë dhe burrat, si dhe të ngrisë vetëdijen tek institucionet dhe gjykatat që të punojnë drejtë dhe në mënyrë të barabartë siç e kërkon ligji.

Përpos grave, synim kanë qenë dhe burrat, ku 28 prej tyre janë kontaktuar mbi këtë çështje. Edhe pse janë shprehur se po u bëhet e padrejtë grave në çështje të pronës, asnjëri prej tyre nuk ka pohuar kur është pyetur se a do të ndante trashëgiminë me motrat e veta. Përgjigjet e tyre veçse kanë treguar gjendjen e realitetit e kjo duhet të merret si thirrje për më shumë punë drejt vetëdijesimit për të drejtat ligjore sa i përket çështjes së pronës, trashëgimisë dhe kontributit të përbashkët martesor.

Shumë gra po vazhdojnë të heqin dorë nga e drejta në pronë, e gjithë kjo nga frika e prishjes së raporteve familjare dhe proceseve gjyqësore shumë të gjata dhe të kushtueshme. Kjo mbetet një çështje serioze për të cilën duhet ende punë për ta ndryshuar.

Mbroj të Drejtat e Tua ngrit vetëdijesimin kundër dhunës në familje në komunën e Deçanit

Organizata Mbroj të Drejtat e Tua (MDT) ka ndërmarrë iniciativë për ngritjen e vetëdijesimit të grave, burrave, të rinjve dhe institucioneve në komunën e Deçanit, mbi dhunën në familje dhe vënien e mekanizmave për parandalimin e saj, me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,856€).

MDT ka mbajtur takime individuale me 10 viktime të dhunës në familje, të cilat janë vizituar në familjet e tyre apo në strehimore. Gratë kanë treguar nevojat dhe vështirësitë me të cilat përballen ato dhe familja e tyre.

“Nga këto takime është krijuar një bashkëpunim me viktimat e dhunës në familje duke i informuar ato për të drejtat e tyre, për institucionet të cilat mund t’ju ndihmojnë si dhe është avokuar tek institucionet që këtyre rasteve tu sigurohet trajtim i duhur dhe riintegrim më i mirë në shoqëri”, ka thënë Fitore Shala, Drejtore Ekzekutive e MDT.

Një nga gratë e cila ka përjetuar dhunë, ka treguar sa të rëndësishme kanë qenë këto takime për te pasi që i kanë dihmuar shumë gjatë procedurave gjyqësore.



“Qasja e përfaqësueseve të organizatës dhe ndihma e tyre së bashku me zyrën e avokatit të popullit dhe zyrën për ndihmë juridike falas, më kanë ndihmuar që procedurat gjyqësore të kryhen me efikasitet”, është shprehur ajo.

Gjithsej, rreth 80 persona kanë përfituar nga kjo iniciativë, përfshirë gratë viktime të dhunës në familje në Komunën e Deçanit dhe familjet e tyre dhe përfaqësues të institucioneve që merren me dhunën në familje në Deçan dhe Pejë.

Në kuadër të aktiviteteve, janë shfaqur dy filma, “Slaves” dhe “Hidden”, që trajtojnë dhunën në familje ndaj grave dhe fëmijëve. Pas shfaqjes së filmave, të rinjtë pjesëmarrës kanë vazhduar diskutimin.

Gjatë këtyre aktiviteteve MDT ka identifikuar nevojat dhe problemet me të cilat ballafaqohen viktimat e dhunës në familje si dhe institucionet të cilat meren me këtë çështje. Andaj, të rinjtë kanë shpërndarë broshura për nxënës në dy shkolla të mesme, me informata për masat që duhet të ndërmarë shoqëria në parandalimin e dhunës në familje.

MDT poashtu ka përpiluar disa rekomandime bazuar në nevojat e grave dhe institucioneve:

- Të punohet në drejtim të aftësimin dhe edukimit të duhur që të krijojë pavarësi ekonomike
- Të këtë psikologë në shkolla fillore të cilët merren me zhvillimin e fëmijëve
- Të marrin trajtimin psikologjik e gjithë familja dhe kryesi i dhunës në familje
- Të vetëdijesohet shoqëria për të drejtat në trashëgimi
- Të zbatohen Ligji për Dhunën në Familje, urdhërat mbrojtës dhe të hyjë në funksion alimentacioni për fëmijë

Në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, MDT ka filluar monitorimin e seancave gjyqësore për rastet e dhunës në familje. Që nga muaji qershor deri me 1 tetor kanë marrë pjesë në 10 raste gjyqësore. Gjatë 10 seancave gjyqësore që kanë montuar, është vërejtur se gjyqtarët në aspektin procedural i kanë respektuar procedurat gjyqësore si dhe rastet e dhunës në familje janë shqyrtuar me prioritet nga ana e

organeve gjyqësore. MDT do të vazhdojë me monitorimin e rasteve të tjera si dhe do të avokoj për të gjitha çështjet me rëndësi për gratë viktime të dhunës në familje.

Vajzat në Prizren bashkëpunojnë me asambleistet

Ligji për Barazi Gjinore i cili siguron barazinë gjinore mes burrave dhe grave në të gjitha sferat e jetës shoqërore, ka hyrë në fuqi në vitin 2015, mirëpo ende nuk zbatohet sa duhet. Që barazia gjinore ka mbetur në një copë letër, këtë e tregon dhe numri i grave të përfshira në politikë dhe vendimarrje i cili është shumë i vogël. Sidomos në komunën e Prizrenit, shumë pak gra mbajnë pozita udhëheqëse, e edhe ndër ato që mbajnë janë kryesisht drejtoresha të shkollave. Në Kuvendin Komunal të Prizrenit nga 13 drejtori, menaxhimi iu është besuar vetëm dy grave në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe në atë të Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ndërsa, në partitë politike nga pesë nënkryetarë, nuk është asnjë nënkryetare.

Vajzat studente nga universitetet publike dhe private, Asambleistet e Kuvendit Komunal, gratë nga forumet e grave në partitë politike dhe shoqëria civile, kanë diskutuar për mundësitë dhe sfidat e grave që të përfshihen në sferën politike. Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,581€), 30 studente përfituese, për herë të parë kanë diskutuar me asambleistet e Komunës së Prizrenit dhe kanë mësuar më shumë për avokimin, udhëheqjen, Rezolutën 1325 dhe Ligjin e ri për Barazi Gjinore.

Në njërin nga trajnimet dy ditore i cili është mbajtur për udhëheqje dhe avokim, vajzat kanë diskutuar direkt me gratë

asambleiste, ku u informuan më shumë për rrugëtimin e tyre në politikë dhe sfidat me të cilat janë ballafaquar.

“Po më vjen shumë mirë që isha pjesë e këtij projekti, që për herë të parë pata mundësinë të komunikojta kaq lirshëm me gratë asambleiste. Nuk duhet të ndalemi, duhet t'i bashkojmë forcat”, ka thënë Flaka Krasniqi, një studente përfituese.

Nga katër muaj të projektit vajzat studente kanë ngritur edhe çështjen e basketbollisteve të klubit “Bashkimi”, të cilat përkundër sukseseve të vazhdueshme vazhdojnë të neglizhohen nga Komuna, duke ndarë një buxhet shumë të vogël. Ato kërkuan nga zyrtarja për barazi gjinore, Mybexhele Zhurri, që të mblidhen dhe të diskutojnë se si mund të ndahet një shumë më e madhe për basketbollistet nga buxheti vjetor. Zyrtarja për barazi gjinore u zotua se kjo çështje do të diskutohet dhe do të mirret parasysht.

Komunikimi mes grave asambleiste dhe vajzave tani më është më i fortë, ndërsa vajzat janë më të vetëdijesuar për rëndësinë e përfshirjes së tyre në politikë dhe vendimmarrje.

Gratë e Shtërpcës më të përgaditura për hapjen e bizneseve

Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim (FEZH) ka filluar iniciativën për aftësimin, krijimin e idesë dhe hapjen e një biznesi të vogël në komunën e Shtërpcës, me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,580€).

Grupi i formuar prej 14 grave përfituese, kanë mbajtur takime ku kanë paraqitur idetë tyre individuale dhe kolektive për të hapur një biznes të vogël, për të punësuar edhe gra të tjera. Gjithsej janë mbajtur dhjetë sesione si dhe takime të ndryshme me zyrtarë

komunal. Në një takim me kryetarin e komunës së Shtërpcës, Bratislav Nikolic, gratë kanë shprehur nevojat e tyre dhe kanë avokuar për mbështetje institucionale. Ata kanë shprehur gadishmërinë e tyre për t'i përkrahur si dhe kanë informuar ato me procedurat dhe ku të drejtohen me kërkesat e tyre specifike.

“Gratë kanë mësuar që të hedhin në letër projektin e tyre. I kemi ndihmuar rreth shkrimit të projektit dhe është parë se çfarë mund të bëjnë gratë dhe për çfarë kanë nevojë”, ka thënë Vjollca Zeqiri. “Një e arritur tjetër është përmirësimi i komunikimit në mes të grupit dhe Komunës, ku është lehtësuar qasja dhe zhvillimi i debateve mbi problemet që kanë”.

Për të përfaqësuar grupin gjatë takimeve dhe aktiviteteve është caktuar një kryesuese e grupit Sylhane Ramadani, që njëkohësisht është kryetare e shoqatës “Boronica e Sharrit”. Rreth 500 broshura janë shpërndarë në secilën zyre të komunës dhe tek përfitueset dhe komuniteti në përgjithësi, me informata të adresave se ku mund të orientohen kur aplikojnë për grante apo donacione, në mënyrë që ta kenë më të lehtë realizimin e ideve të tyre. Poashtu, ato janë regjistruar në zyrën për bujqësi dhe ekonomi, përmes të cilave kanë qasje më të lehtë rreth informimit mbi projekte. Për disa nga pjesëmarrëset, ishte hera e parë që po merrnin pjesë në trajnime të tilla.

“Gjithmonë kam hezituar të kërkoj informata apo diçka tjetër në komunë. Tash pas këtyre trajnimeve nuk hezitoj që të shkoj personalisht në komunë dhe të marr informatat e nevojshme”, ka thënë Afërdita Haziri, e cila për hapje të biznesit ka si ide hapjen e një furrë buke.

Gratë kanë identifikuar mënyra ku gruaja nga shtëpia dhe oborri i saj mund të fitojë një pagë, me të cilën i ndihmon familjes. Ky grup i grave tash është i gatshëm që si grup apo individualisht të aplikojnë për subvencione, të shkruajnë kërkesa

për plan biznese të tyre si dhe të avokojnë për realizimin e qëllimeve të tyre.

Gratë e fshatrave të Prishtinës kyçen sukseshëm në tregun mobil

Gratë e fshatrave Llukarë, Makovc dhe Grashticë gjithmonë kanë dashur të gjejnë mundësi për gjenerimin e të hyrave në bujqësi, mirëpo nuk kanë ditur kujt t'i drejtohen. Organizata Education Code, mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,999€) u ka ofruar atyre këtë mundësi dhe ka arritur që shumë prej tyre t'i kyq në tregun mobil të Prishtinës për të shitur produktet.

Fillimisht kjo organizatë ka bërë një analizë të problemit nga ku kuptuan se gratë nuk janë mjaftueshëm të informuara se si t'i shfrytëzojnë resurset e tyre natyrore. Deri më tani, askush nuk ka punuar drejt zhvillimit turistik dhe bujqësor për këto fshatra, dhe gratë që jetojnë aty nuk kanë pasur mundësi të punojnë për të sjellë të ardhura në familjet e tyre.

Për shtatë muaj radhazi, janë mbajtur takime dhe trajnime me gratë e tri fshatrave dhe zyrtarë të institucioneve, për t'i informuar dhe për t'ju ndihmuar se si të hapin një biznes të vogël për resurset e tyre natyrore.

“Më herët nuk e kam ditë se si të kyçem në treg edhe pse kam pasur shumë dëshirë, por tani me të gjitha informatat e fituara nga aktivitetet, arrita të dal dhe të shes produktet e mia”, ka thënë Elfete Krasniqi, përfituese e kësaj iniciative.

Gratë kanë ngritur kapacitetet e tyre në mënyrën e aplikimit për grante dhe se si ti drejtohen institucioneve për hapjen e biznesit për koshere të bletëve, bylmet, arra, dredhëza apo mjedra. Ato menjëherë kanë shfrytëzuar mundësitë për

aplikim, dhe disa prej tyre edhe kanë përfituar. Gjithshtu, ato janë informuar për subvencionet dhe grantet që ndahen nga komuna e Prishtinës dhe Ministria e Bujqësisë për këto fshatra.

“Në faqen zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë, kemi parë që zakonisht përfitues të granteve për bujqësi janë fshatrat e zonave të Rrafshit të Dukagjinit apo vendeve të tjera, por këto fshatra të Prishtinës deri më tani kanë mbetur shumë anash. Kjo na zgjoi kureshtjen për të kuptuar pse dhe si mund tu ndihmojmë”, tregoi Vjosa Preniqi, menaxhere e organizatës Education Code.

Vajzat kanë shprehur interesim të madh në trajnimet ku janë ofruar informata se si të aplikojnë për vende pune, si të krijohet një CV dhe letër motivuese si dhe për përdorimin e rrjeteve sociale nga të cilat mund të depërtojnë më lehtë me biznesin e tyre duke reklamuar produktet.

Pasi që u pa nevoja e koordinimit, të gjitha vendosën që të formojnë një OJQ ku të gjitha problematikat dhe interesat të drejtohen përmes saj. Ato kanë filluar bashkëpunimin dhe janë duke përgaditur dokumentet e nevojshme për të hapur OJQ-në. Përveq kësaj, gratë kanë një lokal në njërin nga fshatrat, të cilin po planifikojnë ta rregullojnë dhe ta shëndrrojnë në një pikë atraktive turistike për të shitur produktet e tyre, nga ku edhe mund t'i distribuojnë nëpër markete të tjera.

Komuna e Mamushës me Plan të Veprimit për Barazi Gjinore

Në komunën e Mamushës ekzistojnë shumë raste të martesave të hershme dhe braktisjes së shkollimit të vajzave pas përfundimit të shkollës fillore, ndërsa numri i grave dhe vajzave në vendimmarrje është shumë i vogël ose nuk ka fare. Mungesa

e politikave gjinore në këtë komunë, është njëra prej pengesave për planifikimin e mirëfilltë të projekteve dhe angazhimit të institucioneve lokale dhe të shoqërisë civile në drejtim të avancimit të barazisë gjinore.

Duke e parë një situatë të tillë, organizata Dora Dorës me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,994€) ka përgaditur Planin e Veprimit për Barazi Gjinore 2017-2019, i cili edhe është aprovuar nga Kuvendi i Mamushës. Ky plan rregullon fushat më të rëndësishme si arsimimi, shëndetësia, fuqizimi ekonomik, gratë në politikë dhe vendimmarrje, dhuna në familje dhe shumë të tjera. Poashtu, për secilën nga këto fusha është paraparë se kush mban përgjegjësinë për zbatimin e tyre, përfshirë buxheti.

“Këto gra punojnë shumë, kultivojnë pemë dhe perime, bëjnë punë dore dhe është e nevojshme që gjithë ajo punë e tyre të njihet dhe nga të tjerët. Gjithashtu shkollimi i vajzave është i domosdoshëm”, ka thënë Luljeta Avdiq, menaxhere e projekteve në organizatën Dora Dorës.

Për të përpiluar këtë plan sa më mirë, Dora Dorës ka organizuar takime në formë punëtorie me përfaqësues institucional, zyrtare për barazi gjinore, drejtorë relevant të komunitetit turk dhe shqiptarë, gra dhe burra. Gjatë këtyre takimeve janë përcaktuar fushat kryesore të veprimit, objektivat dhe aktivitetet konkrete mbi analizën e gjendjes në komunën e Mamushës në aspektin e barazisë gjinore. Në një nga takimet, Seilan Mazrek, zyrtare për të drejtat e njeriut në Komunën e Mamushës, ka treguar për rëndësinë e këtij plani, plan i cili rregullon çështjet se si gratë të kenë më shumë të drejta në fushat përkatëse.

Përfitues, përfshirë gra e burra që kontribuan direkt në realizimin e tij, ishin 189 persona. Tani gratë që veprojnë në komunën e Mamushës, e kanë më të lehtë të punojnë mbi

nevojat e komunitetit ku jetojnë. Ato gjithashu do të vazhdojnë të informojnë sa më shumë qytetarët, për ekzistencën e Planit të Veprimit për Barazi Gjinore dhe rëndësinë e tij.

Gratë, vajzat dhe burrat vetëdijesohen për të drejtat mbi pronë dhe trashëgimi

Në Kosovë, gratë ende përballen me sfida të shumta për të realizuar të drejtat e tyre mbi trashëgimi dhe pronë. Konfliktet familjare, proceset e gjata gjyqësore, po bëjnë që gratë të mos kenë guxim të kërkojnë të drejtën e tyre.

Ishte një rast në familjen e saj, kur Afërdita Zeneli, Drejtore Ekzekutive e organizatës Dita, ka vendosur t'i ndihmojë gratë dhe t'ju jap guximin që të luftojnë për të drejtat e tyre për trashëgimi dhe pronë. Mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,968€), organizata Dita ka aftësuar 70 gra nga komuna e Gjilanit dhe gjashtë fshatra përreth, mbi të drejtat e tyre për pronë dhe trashëgimi dhe si t'i realizojnë ato. Deri tani tri gra kanë regjistruar pronën në emër të tyre.

“Babai im na ka ndarë fëmijëve trashëgiminë në mënyrë të barabartë, por ja që prapë ndodhën konflikte në familje. Edhe pse tani çështja është zgjidhur, e kuptoj shumë mirë se në çfarë kalon një grua kur përballlet me këtë sfidë”, ka thënë Afërdita Zeneli.

Në takimet e organizuara, u ftuan zyrtarë të institucioneve, nga zyra e trashëgimisë dhe gjykata themelore e Gjilanit, të cilët folën për procedurat gjyqësore dhe përmbajtjen e ligjit, duke ju sqaruar që ligji është i barbartë për të gjithë. Është vërejtur që gratë kanë dashur shumë më herët të realizojnë të drejtat e tyre mbi pronë dhe trashëgimi, por nuk kanë pasur njohuri se ku të drejtohen apo si ti qasen problemit. Në të njëjtën kohë edhe

burrat dhe djemtë janë shprehur që sipas njohurive të tyre kanë menduar që Ligji për Pronë dhe Trashëgimi u cënon atyre të drejtat dhe vlenë vetëm për gratë.

Prandaj, organizata Dita, përmes trajnimeve u ka spjeguar çdo paqartësi dhe informatë që nuk kanë pasur lidhur me këtë ligj dhe të drejtat e grave sipas ligjit.

“Nuk e kemi ditur se ligji funksionon kështu, kam menduar që ky ligj po i favorizon vetëm gratë e neve burrave jo”, ka thënë një nga burrat pjesëmarrës.

Më të interesuarat për këtë çështje ishin vajzat, të cilat kanë shprehur dëshirën dhe motivimin të informohen sa më shumë në mënyrë që të mos kenë konflikte familjare dhe të jenë të afta për të inicuar procedurat e ndarjes së pronës dhe trashëgimisë.

Speranza në solidaritet me gratë që përjetojnë dhunë në familje

Sipas raportit të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës *Mjaft më me Arsyetime*, 68% e grave dhe 56% e burrave kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës në familje gjatë jetës së tyre. Në vitin 2014, rreth 41% e grave dhe 20% e burrave kanë përjetuar dhunë në familje në Kosovë.

Aktivistet e oranzatës Speranza nga Mitrovica ngritën shqetësimin e tyre për rritjen e rasteve të dhunës në familje në komunën e tyre. Një nga shetësimet ishte që as institucionet si komuna, Qendra për Punë Sociale dhe Policia nuk po punojnë mjaftueshëm për të adresuar dhunën ndaj grave. Me mbështetjen e Fondit të Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,929€), Speranza ka planifikuar tu ofroj përkrahje grave që

kanë përjetuar dhunë në familje, duke u siguruar që gratë janë të noftuara për të drejtat e tyre ligjore.

Speranza ka organizuar takime të rregullta me dymbëdhjetë gra që kanë përjetuar dhunë në familje. Lirie Sadiku, avokate, i ka informuar gratë për dhunën në familje, format e ndryshme të dhunës dhe mënyrat se si të identifikohen shenjat e dhunës psikike dhe fizike. Së bashku me pjesëmarrëset, ato gjithashtu diskutuan për hapat që mund të ndërmerren në parandalimin e dhunës në familje, si dhe mënyrat për të pasur qasje edhe tek vajzat dhe për t'i informuar ato lidhur me dhunën në familje dhe pasojat e saj. Gratë mësuan se si të përgaditen për raste për në gjykatë dhe tek cilat institucione t'i adresojnë ato.

“Nuk kisha ku të ankojem për gjendjen time të vështirë”, u shpreh një grua pjesëmarrëse në takim. “Unë jam jetime, nuk kam familje. Burri më rrahë. Së paku, gratë këtu [në këtë takim] e kuptojnë situatën time më mirë se kushdo tjetër,” shtoi ajo.

Ndoshta një nga kontributet kryesore të kësaj iniciative ishte ofrimi i një hapësire për gratë që kanë përjetuar dhunë në familje që të flasin me gra të tjera të cilat kanë përvoja të njejta. Kjo është një formë mekanizmi mbështetës shumë i rëndësishëm për gratë që kanë mbijetuar dhunën.

Përveq dhunës në familje, ato gjithashtu diskutuan për forma të tjera të dhunës në baza gjinore.

“Është me rëndësi të flasim për keqtrajtimin e adoleshentëve që tërë kohën janë të rrezikuar nga abuzimi dhe ngacmimi seksual”, tha Sadiku, “dhe mënyrat se si t'i vetëdijesojmë ata për dhunën në familje”.

Speranza ka përkrahur edhe punonjësit nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRMT),

anëtare e RrGGK. Ky trajnim ka mësuar pjesëmarrësit se si të përballojnë stresin.

Shumë nga gratë pjesëmarrëse në trajnimet e shumta të organizuara, tani janë më të hapura dhe kanë filluar të shprehen më lirshëm me të tjerët për problemet që kanë në jetë. Edhe pse ky projekt ka përfunduar, Speranza planifikon të vazhdoj t'i ndihmoj ato edhe në të ardhmen.

Shoqata e Femrave të Shurdhëra avokon për të drejtat e grave në shëndetësi

Pesëmbëdhjetë gra dhe vajza të shurdhëra Shqiptare dhe Rome, të moshave të ndryshme dhe nga vendet rurale kanë marrë pjesë në takimet e organizuara nga Shoqata e Femrave të Shurdhëra (ShFSh). Gjatë takimeve ato kanë mësuar për kancerin në gji, kancerin në mitër dhe se si të shohin shenjat e para të kancerit. Kjo iniciativë është mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës (me vlerë prej 2,966€).

Laura Guguli, gjinekologe, ka këshilluar gratë lidhur me kancerin dhe u ka mundësuar anëtareve të ShFSh të bëjnë vizita falas. Ky bashkëpunim me ShfSh ka vazhduar edhe pas përfundimit të projektit. Gjithashtu, pas kontrolleve, janë diagnostifikuar disa raste me kancer të personave të shurdhër.

“Kemi zbuluar kancerin tek dy anëtare të organizatës”, ka thënë Drejtorja Ekzekutive, Krenare Gashi. Kjo ka shtyrë organizatën të kërkojë asistencë. “Për një nga anëtarët, një asambleiste ka dhuruar 300€ që të ndihmoj në trajtimin e kancerit, dhe ne githashtu e kemi bërë të mundur për te të marrë pension si e shurdhër.”

ShfSh ka përdorur një formë artistike për të avokuar për të drejtat e personave të shurdhër për shëndetësi, duke xhiruar

një film të metrazhit të shkurtër që quhet “Rryshfeti”. Ky film paraqet se si pacientët, sidomos gratë, trajtohen shumë keq nga qendrat e shëndetësisë. Në të njejtën kohë, filmi jep një mesazh kundër korrupsionit në institucionet shëndetësore. Ky film është shfaqur në Qendrën Kulturore në Prizren.

Sipas kërkesës së të shurdhërve, ShfSh ka avokuar tek qeveria lokale që të punojnë më shumë drejt përmirësimit të gjendjes shëndetësore për personat e shurdhër dhe të ketë mundësi punësimi për personat e shurdhës dhe me nevoja të veçanta. Ato gjithashtu kanë avokuar tek Departamenti i Shëndetësisë në Prizren që të sigurohen që interpretimi i gjuhës së shenjave të jetë gjithmonë në dispozicion në emergjencë dhe poashtu në qendrat e shëndetësisë. Tek po i njejtë departament ato avokuan edhe për medikamente falas për personat e shurdhër. Një ide ishte të krijohen kartela posaqërisht për personat e shurdhër që do të mund t'i përdorin kur bëjnë vizita shëndetësore. Këto kartela, automatikisht do t'i mundësonin pacientëve të mund t'i vëjnë në bankomat për të marrë barna apo të bëjë një vizitë mjekësore dhe përmes kësaj karteje të identifikohet.

Të diplomuarit Rom, Ashkali dhe Egjiptian aftësohen për punë

Grupet etnike rom, ashkali dhe egjiptian përbëjnë një deri në tre përqind të popullatës në Kosovë. Shumë studime tregojn se ata janë një ndër grupet etnike më të marginalizuara. Shumë pak rom, ashkali dhe egjiptian mbajnë pozita në politikë, dhe shkalla e papunësisë është më e larta në Kosovë. Numri i studentëve të diplomuar të grupeve etnike rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë është mjaft i vogël. Martesat në moshën e

hershme bëjnë që vajzat të braktisin shkollimin para përfundimit të universitetit. Megjithatë, në vitet e fundit është rritur numri i të diplomuarve. Edhe pas diplomimit, romët, ashkalitë dhe egjiptianët hasin në pengesa për të gjetur punë, gjë që nuk ndodh me grupet e tjera etnike.

“Kur kam aplikuar për një pozitë të hapur pune, më është thënë që ‘nëse do të ishte shqiptar, do të ishte zgjedhur pa problem’”, ka thënë një i diplomuar në universitet, që rikujtonte përvoja të tjera të hidhura në kërkim të punës.

Pa marrë parasysh legjislacionin në fuqi anti diskriminues, lidhur edhe me praktikën e punës, provat nga përvojat tregojnë që shumë shpesh romët, ashkalitë dhe egjiptianët përballen me diskriminim kur aplikojnë për punë.



Pas identifikimit të këtyre sfidave në komunën e tyre në Gjakovë, Qendra Kosovare për Zhvillim dhe Integrim Multikulturor (QKZhim) ka vendosur të ofrojë trajnime në mënyrë që të përgadisë sa më mirë romët, ashkalitë dhe egjiptianët e diplomuar të kenë sukses kur aplikojnë për puna, me fokus tek vajzat. Iniciativa e tyre është mbështetur nga Fondi i Grave të Kosovës (me vlerë prej 3,000€).

“Qëllimi ynë ishte t’i përgadisim studentët se si të aplikojnë dhe mbi procedurat që kërkohen,” ka thënë Elvane Qorri, Drejtore Ekzekutive e QKZhim. “Askush më parë nuk është marrë me këta studentë. Gjithmonë janë neglizhuar.”

Studentët pjesëmarrës në këto takime dhe trajnime thanë që kjo ishte hera e parë që kanë marrë pjesë në një aktivitet të tillë apo që kanë marrë certifikata për pjesëmarrje

në trajnim. Po ashtu ishte hera e parë që dikush interesohej në punën e tyre.

“Nëse trajnime të tilla do të ishin organizuar më parë, do të ishte shumë e lehtë për neve të aplikojmë për puna dhe të familjarizohemi me procedurat”, ka thënë një i diplomuar.

Një sfidë tjetër është fushat që ata kanë diplomuar. Shumica e studentëve kanë studiuar për edukim, që limiton mundësitë për punë në dispozicion për ta.

“Ne do të punojmë me shkollat e mesme në mënyrë që t’i këshillojmë nxënësit lidhur me fushat që ata mund të zgjedhin dhe llojet e pozitave që kërkohen më shumë për punësim”, ka thënë Qorri.

QKZHIM gjithashtu ka avokuar tek institucionet locale, duke insistuar që kuotat për punësim të vendosen për personat e grupeve etnike minoritete.

Pas avokimit të tyre, Ali Tafarshiku, Këshilltar i Kryetarës së Komunës së Gjakovës Mimoza Kusari-Lila, ka thënë që nëse dy apo tre persona aplikojnë për një pozitë, komuna do të ofroj trajnime falas që t’i ngrisë kapacitetet e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në mënyrë që të jenë të përgaditur të garojnë barabart me kandidatët e tjerë.

Më tutje, Zyra për Komunitete në Gjakovë për momentin ka shumë pozita të hapura pune. QKZHIM ka avokuar me sukses që kjo zyrë të përfshijë një fjali në shpalljet për punë që inkurajon vajzat të aplikojnë, drejt avancimit të barazië gjinore brenda qeverisjes lokale.

The first part of the document discusses the importance of maintaining accurate records of all transactions. It emphasizes that every receipt, invoice, and bill should be properly filed and indexed for easy retrieval. This not only helps in tracking expenses but also ensures compliance with tax regulations.

In the second section, the author provides a detailed breakdown of the company's financial performance over the past year. This includes a comparison of actual results against budgeted figures, highlighting areas of both success and concern. The analysis covers revenue growth, cost management, and overall profitability.

The third section focuses on the company's strategic initiatives and future outlook. It outlines the key goals for the upcoming year, such as expanding into new markets and investing in research and development. The author also discusses potential risks and how the company plans to mitigate them.

Finally, the document concludes with a summary of the key findings and recommendations. It reiterates the need for continued financial discipline and strategic focus to ensure long-term success. The author expresses confidence in the company's ability to overcome challenges and achieve its goals.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Rr. Hajrullah Abdullahu, Nr. 25

10000 Prishtinë, Kosovë

+381 (0) 38 245 850

www.womensnetwork.org

info@womensnetwork.org

[Facebook: Kosova Women's Network](#)



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i
menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian